

Ibën Kajjim el-Xheuzi

Përshkrimi i
Xhenetit



Titulli i originalit:	Sifetul Xhenne
Reduktim i veprës:	Hadi'l-ervah ila biladi'l-efrah
Reduktimin e bëri:	Abdu'l-Karid Ahmed 'Ata'
Titulli në gjuhën boshnjake:	Knjiga o Xhennetu
Përktheu:	Muhamed Bajrami
Lekturoi:	Besnik Hamiti
Përgatitja kompjuterike dhe ballina:	Muhamed Bajrami

ARGUMENTET SE XHENETI ËSHTË I KRIJUAR.....	6
Pseudoargumentet e atyre që thonë se Xheneti akoma nuk është krijuar	10
Përgjigjja ndaj këtyre argumenteve.....	11
DIVERGJENCA NË MENDIME MES NJERËZVE PËR XHENETIN NË TË CILIN U VENDOS ADEMI, ALEJHI SELAM	14
ARGUMENTET E DY GRUPEVE, ARGUMENTET QË JANË NË FAVOR TË TYRE DHE ATO QË I DEMANTOJNË ATA	17
Argumentet e atyre që konsiderojnë se bëhet fjalë për Xhenetin e përjetshëm	17
Argumentet e atyre që konsiderojnë se bëhet fjalë për Xhenetin në Tokë.....	20
DYERT E XHENETIT	24
Numri i dyerve të Xhenetit.....	24
Madhësia e dyerve të Xhenetit	25
KU GJENDET XHENETI?	27
ÇELËSI I XHENETIT	29
Shfrytëzimi i portave (dyerve) të diturisë.....	30
VETËM NJË RRUGË ÇON NË XHENET	31
NIVELET E XHENETIT DHE SHKALLA E TIJ MË E LARTË	34
Pozita më e lartë në Xhenet.....	36
ALLAHU UA KA OFRUAR XHENETIN ROBËRVE TË TIJ	38
BESIMTARËT E KËRKOJNË XHENETIN EDHE XHENETI I KËRKON ATA	42
EMRAT E XHENETIT DHE KUPTIMET E TYRE	45
Emri i parë - Xhenet	45
Emri i dytë – Daru's-selam	45
Emri i tretë – Daru'l-huld	47
Emri i katërt – Daru'l-mukameh	47
Emri i pestë – Xhenetu'l-me'va	48
Emri i gjashtë – Xhenetu 'adn	48
Emri i shtatë - Daru'l-hajevan.....	49
Emri i tetë - El-Firdeus	50
Emri i nëntë – Xhenetu'n-ne'im	50

Emri i dhjetë – El-mekamu'l-emin	51
Emri i njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë – Mak'adu's-sidk ve kademu's-sidk	51
TË PARËT QË DO TË HYNË NË XHENET	53
I pari që do të troket në dyert e Xhenetit	53
Populli i parë që do të hynë në Xhenet	54
Pasuesit e parë të Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, që do të hyjnë në Xhenet	54
Të varfërit do të hyjnë në Xhenet para të pasurve	55
ATYRE QË U ËSHTË GARANTUAR XHENETI	57
NË XHENET DO TË KETË MË TEPËR GRA SE BURRA, POR PO ASHTU EDHE NË XHEHENEM	59
ATA QË DO TË HYNË NË XHENET PA DHËNË LLOGARI	61
Grushti i Zotit të Lartësuar	63
CILËSITË E XHENETIT	64
Drita e Xhenetit dhe bardhësia e tij	65
Pallatet e Xhenetit	65
Aroma e Xhenetit	67
BANORËT E XHENETIT	68
Ata do t'i dinë vendbanimet e tyre në Xhenet	68
Veçoritë e banorëve të Xhenetit dhe mosha e tyre	69
POZITA MË E LARTË DHE MË E ULËT NË XHENET	71
EZANIN QË DO TA THËRRET MUEZINI I XHENETIT	73
DRUNJTË, FRUTET DHE LUMENJTË E XHENETIT	74
Frutet e Xhenetit dhe veçoritë e tyre	75
Bujqësia në Xhenet	76
Burimet dhe lumenjtë e Xhenetit	77
USHQIMI, PIJET DHE RROBAT E BANORËVE TË XHENETIT	81
Ushqimi dhe pijet e banorëve të Xhenetit	81
Rrobat dhe shtrati i banorëve të Xhenetit	84
Shërbëtorët	86
GRATË E BANORËVE TË XHENETIT	87
Shtatzënia (graviditeti) dhe lindja e fëmijëve në Xhenet	90
SHOQËRIMI I BANORËVE TË XHENETIT	91

Dëgjimi i banorëve të Xhenetit	91
Vizita e ndërsjellë e banorëve të Xhenetit	92
Tregu i Xhenetit	94
A DO TA SHOHIN XHENETLINJTË ZOTIN E TYRE TË LARTËSUAR DHE MADHËRUAR	95
MBI PËRJETËSINË DHE PËRHERSHMËRINË E XHENETIT	102
KUSH DO TË HYJË I FUNDIT NË XHENET?	109
MBI ATA QË E MERITOJNË LAJMIN E GËZUAR	110

KAPITULLI I PARË

ARGUMENTET SE XHENETI ËSHTË I KRIJUAR

Të gjithë sahabët e Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, pasuesit e tyre dhe gjeneratat e muslimanëve pas tyre, dijetarët e Sunetit dhe hadithit, juristët islam, mbrojtësit e tesavufit dhe zuhdit, bindshëm besojnë se Xheneti është i krijuar dhe këtë e vërtetojnë duke u mbështetur në tekstet e Kur'anit, Sunetit dhe në atë që është e njohur në fe si elementare, në pajtim me mësimet e pejgamberëve, që nga i pari e deri te i fundi, ndërsa ata kanë thirrë popullin e tyre në Xhenet dhe kanë folur për te derisa nuk është zhvilluar (ka mbirë) fara e kaderive¹ dhe mu'tezilive², të cilët kanë refuzuar se Xheneti është krijuar si dhe kanë konstatuar se Allahu do ta krijojë atë në Ditën e Gjykimit.

Deri te kjo i ka sjellur principi i tyre i gabuar gjatë të cilit kanë konstatuar, se Allahu duhet ta bëjë këtë dhe këtë, e nuk duhet ta bëjmë këte ose atë. Ata thonë: "Krijimi i Xhenetit para shpërblimit është i pakuptimtë, kurse mirë-

¹ Kaderitë janë sektë të cilët thonë se njeriu ka liri të plotë të veprimit (N. Smailagiq, *Kultura klasike e Islamit I*, Zagreb, 1976, fq.299).

² Mu'tezilitë ishin shkollë tejet racionaliste e orientuar në Islam. Themeluesi i saj ishte Vasil ibën 'Ata' (748), kurse principet themelore të tij ishin: Njeshmëria e Allahut (*tehud - me këtë kishin për qëllim mohimin e emrave dhe cilësive të Allahut*), Drejtësia e Allahut ('*adl*), premtimi dhe kërcënimi (*va'd ve ve'id*), ai që bën mëkate të mëdha është ndërmyjet kufrit dhe imanit (*menzila bejne menziletejn*) dhe urdhërimi në mirë dhe ndalimi nga e keqja (*el-emru bi'l-na'raf ve'n-nehju 'ani'l-munkar*) (M. M. Sharif, *Historia e filozofisë Islame I*, përktheu Hasan Sushiq, ITRO August Cesarec, Zagreb, 1988, fq. 219; N. Smailagiq, *vepra e sipërpërmendur*, fq. 15-154).

mbajtja e tij është e padobishme nëse në te nuk ka banorë". Kështu ata e kufizojnë Allahun e Lartësuar me kuptimet e tyre të gabuara dhe qëndrimet e tyre të devijuara, ndërsa punët e Tij i krahasojnë me punët e tyre; i refuzojnë ato pjesë me përmbajtje të shpalljes që kundërshtohen me këtë princip të gabuar që ia kanë përshkruar Zotit ose i komentojnë jashtë kontekstit; i konsiderojnë të lajthitur dhe bidatçi ata që nuk pajtohen me ta; e konsiderojnë një gjë obligative për të cilën janë përqeshur nga ana e njerëzve të mençur.

Prandaj muslimanët e gjeneratave të para në besimet e tyre kanë shënuar se Xheneti dhe Xhehenemi janë krijuar, kurse në veprat mbi sektet e ndryshme ceket se të gjithë pasuesit e Sunetit dhe hadithit mbrojnë këtë mendim dhe nuk ka divergjencë në mendime për këtë çështje.

Kurse për atë se Xheneti është i krijuar, tregojnë fjalët e Allahut të Lartësuar në Kur'an:

﴿عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَىٰ ﴿عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ﴾

"(E ka parë) tek Sidretul Munteha. Që pranë saj është Xhenetul Me'va".³ Pra, Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, e ka parë Sidretu'l-munteha-në dhe po aty e ka parë vendbanimin në Xhenet, siç ceket në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit, në hadithin mbi Isranë të cilin e transmeton Enesi, radijallahu anhu. Në fund të këtij hadithi thuhet: "Më pastaj vazhduam bashkë me Xhibrilin derisa arritëm në Sidretul-munteha të cilin e kishin mbuluar ngjyra të ndryshme, aq të larmishme ishin sa që unë nuk di se sa lloje ishin. Pas kësaj më futën (në Xhenet) ku pashë kube me gurë të çmueshëm, kurse toka ishte nga misku".

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar hadithi i Abdullah ibën Omerit i cili transmeton se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

³ Nexhm: 14-15.

"Kur ndokush prej jush vdes, i tregohet vendi i tij në mëngjes dhe mbrëmje, e nëse është banor i Xhenetit, i tregohet vendi i tij mes banorëve të Xhenetit, e nëse është banor i Xhehenemit, i tregohet vendi mes banorëve të Xhehenemit, dhe i thuhet: 'Ky është vendi yt!', derisa Allahu i Lartësuar nuk e ringjallë në Ditën e Gjykimit".

Në veprat e përmendura të hadithit (këtu do të cekim transmetimin nga Sahihu i Buhariut), transmetohet se Abdullah ibën Abasi ka thënë: "Në kohën e Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, erdhi deri te errësimi i Diellit, dhe mëpastaj ai e cekë hadithin: *Vërtetë dielli dhe hëna janë dy shenja (argumente) prej shenjave të Allahut të cilat nuk errësohen për shkak të vdekjes apo lindjes së dikujt. E kur të shihni (errësimin e ndonjëres prej tyre), atëherë faluni dhe lexoni lutje derisa të mos kalojë errësimi që ju ka kapluar. Të pranishmit thanë: O i Dërguar i Allahut, të pamë se si nga vendi yt merr diç, e mandej të pamë duke u tërhequr. Pejgamberi u tha: E pashë Xhenetin dhe desha të marr një kalavesh me rrush, e sikur ta mirrja, do të hanit prej tij derisa të ekzistonte kjo botë".*

Në Sahihun e Buhariut ceket rrëfimi i Esmës, bijës së Ebu Bekrit, e cila transmeton se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, pas faljes së namazit gjatë marrjes së Diellit ka thënë: "Më është afruar Xheneti, e sikur të guxoja, do të mund t'u sjellja prej tij një kalavesh me rrush të freskët. Më është afruar Xhehenemi, e aty pashë një grua (mendoj se tha) të cilën e gëroishte një macë. E pyeta: 'Çështë puna me te?', e ai më tha: 'Një grua do të hyjë në Zjarr shkakut i macës. E pat lidhur ate dhe nuk e ushqeu e as nuk e la që vetë të ushqehet'".

Hadithe të ngjashme transmetojnë edhe Xhabir ibën Abdullahu (përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit), Aishja (përmbledhja e Muslimit), Abdullah ibën Amri, Ibnul Asi (Musnedin e Ahmed ibën Hanbelit dhe Sunenin e Ebu Davudit).

Në Sahihun e Muslimit është shënuar hadithi nga Enesi, radijallahu anhu, i cili thotë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: *Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ta kishit parë atë që unë e kamë parë, pak do të qeshnit e shumë do të qanit. Të pranishmit e pyetën: E çfarë ke parë, o i Dërguar i Allahut?. 'E kam parë Xhenetin dhe Xhehenemin' - u përgjigj Pejgamberi".*

Në Muveta-në dhe Sunen-in e Ebu Davudit është shënuar nga Ka'b ibën Maliku i cili thotë: "Shpirti i besimtarit është zog i cili ushqehet nga druri i Xhenetit, derisa Allahu nuk e kthen në trupin e tij në Ditën e Gjykimit". Kjo në mënyrë të qartë flet për ate se shpirti hyn në Xhenet para Ditës së Gjykimit.

Autorët e Sunenit kanë shënuar nga Ka'b ibën Maliku (Tirmidhiu thotë se hadithi është autentik) i cili thotë se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Shpirtat e shehidit marrin formë të zogut të gjelbërt i cili ushqehet nga frytet e drunjve të Xhenetit".

Ekzistojnë edhe hadithe tjera të ngjashme në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit - nga Ebu Hurejre, Ebu Se'idi dhe Ibën Omeri, nga Ebu Hurejra dhe Xhabir ibën Abdullahu (në përmbledhjen e Muslimit), kurse në të Buhariut nga Enesi, radijallahu anhu.

Nëse ndokush pyet: "Pse nuk e keni argumentuar qëndrimin se Xheneti vetëm se ekziston me rrëfimin e Ademit, hyrjen e tij në Xhenet, daljen prej tij shkakut i ngrënies së frytit prej drurit të ndaluar, kur këto janë argumente të qarta?", do t'u përgjigjemi: "Edhe pse këto janë argumente të qarta për shumicën, prapëseprapë do të mbetej një lloj dyshimi, për shkak të mospajtueshmërisë së njerëzve në pikëpamje të Xhenetit në të cilin është vendosur Ademi, alejhi selam, d.m.th., a ka qenë pikërisht ky Xheneti i përhershëm në të cilin do të vendosen besimtarët në Ditën e Gjykimit?".

Pseudoargumentet e atyre që thonë se Xheneti akoma nuk është krijuar

Përfaqësuesit e këtij qëndrimi thonë: "Sikur Xheneti të ishte krijuar, do të duhej të zhduket kur të vinte Dita e Kijametit dhe kur do të shkatërrohej e gjithë ajo që është në te, ngase Allahu i Lartësuar thotë:

﴿... كُلُّ شَيْءٍ حَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ...﴾

"Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij".⁴ Në këtë rast do të vdisnin hyritë dhe shërbëtorët e Xhenetit, kurse Allahu ka lajmëruar se Xheneti është Shtëpia e amshueshmërisë dhe ata që janë aty mbenen përgjithmonë dhe nuk vdesin, dhe deklaratën e Tij nuk duhet ndërruar me diç tjetër, e as deroguar".

Tirmidhiu në *Xhami'un* e tij ka shënuar hadithin e Ibën Mes'udit i cili thotë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: 'E kam takuar Ibrahimin në natën e Israsë dhe ai më ka thënë: O Muhamed, përcjellu selam umeetit tënd prej meje dhe lajmëroi se Xheneti ka tokë të butë, ka ujë të ëmbël dhe rrafshina pjellore (të frytshme), kurse flora (bota bimore) e saj janë: Subhanallahu, El-hamdulilahi, La ilahe illallah dhe Allahu ekber'." Ky hadith është *hasen-garib*.⁵ Në të njëjtën vepër është shënuar edhe hadithi nga Xhabiri, radijallahu anhu, i cili transmeton se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kush thotë: Subhanallahu ve bi hamdihit do t'i mbjellat një palmë në Xhenet". Hadithi është *sahih* (i vërtetë).

⁴ El-Kasas: 88.

⁵ Me hadith *hasen-garib* nënkuptohet se hadithi është i mirë, por edhe i jashtëzakonshëm për shkak se transmetohet vetëm nga një njeri, respektivisht nuk ka rrugë tjera të transmetimit që do ta vërtetonin.

Thonë: Nëse Xheneti është krijuar pa mbjella, atëherë ate nuk e përbëjnë rrafshinat pjellore, prandaj edhe kjo mbjellje nuk ka kuptim.

Në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit është shënuar hadithi ku Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thotë: "Kush ndërton një xhami për hirë të Allahut, goftë edhe sa një kotec i shpendëve (për vezë), Allahu do t'i ndërtojë atij një shtëpi në Xhenet". Kjo fjali përmban kusht dhe shpërblim, si dhe nënkupton përfitimin e shpërblimit menjëherë pas plotësimit të kushtit, sipas konsensusit të gjuhëtarëve arabë. Hadithi përndryshe, në mënyrë të besueshme është transmetuar nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, përmes Othmanit, Aliut, Xhabirit, Enesit dhe Amër ibën Anbesit. Do të ishte absurde po që se atij që të ka qepur rroba t'i thuash: "Mi qep teshat!".

Thonë: Në transmetime thuhet se në Xhenet melekët mbjellin fidane dhe ndërtojnë shtëpi për njeriun, derisa ai punon punë të përshtatshme në këtë botë, e nëse njeriu ndalet, ndalen edhe melekët dhe e ndalin punën e mëtutjeshme. Pastaj ata thonë: këto nuk janë qëndrime të bidatçive dhe mu'tezilive, siç thoni ju, sepse Ibën Mezinë në tefsirin e tij thotë se Nafi'u është njëri nga njohësit më të mirë të Sunetit, kur është pyetur se a është Xheneti i krijuar apo jo, është përgjigjur: "Heshtja për këtë çështje është më e mirë, e Allahu e di më së miri!".

Përgjigjja ndaj këtyre argumenteve

Më parë janë cekur mjaft argumente se Xheneti vetëm se ekziston. Prandaj, ne themi: "Në çka aludoni me qëndrimet tuaja - se Xheneti ende nuk është krijuar? Doni të thoni se ende nuk ekziston, se ai do të krijohet pasi që t'i fryhet surit dhe të ringjallen njerëzit prej varreve?". Ky qëndrim nuk është i drejtë, këtë e përgënjeshtrojnë

hadithet e qarta të sipërpërmendura dhe askush nga gjeneratat e para të muslimanëve e as nga pasuesit e Sunetit nuk kanë pasur këso qëndrime. Ose doni të thoni se Xheneti dhe gjithë atë që Allahu e ka premtuar për banorët e tij nuk janë krijuar në tërësi, se Allahu vazhdimisht krijon diç të re në te, njërën pas tjetrës, dhe kur besimtarët të hyjnë në te, Allahu do të krijojë dhe disa gjëra tjera?! Kurse pikërisht kjo është e vërteta e cila nuk mund të përgënjeshtrohet. Argumentet tuaja pikërisht udhëzojnë në këtë.

Hadithin që e transmeton Ibën Mes'udi, të cilin e keni cekur, tregon qartë se toka e Xhenetit është krijuar, se Allahu krijon fidane (drunj) në Xhenet për atë që bënë dhikër dhe Ai bën që të krijohen shtëpi si shpërblim për punët e përmendura. Sa herë që njeriu bën punë të mira, Allahu shumëfishon shpërblimet në Xhenet. Vallë të gjitha këto (argumente) nuk udhëzojnë se Xheneti është i krijuar?!

Sa i përket thirrjes suaj në fjalët e Allahut të Lartësuar: *"Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij"*, ju, duke mos e kuptuar ajetin, keni sjellur përfundim të gabuar. Argumentimi i qëndrimit tuaj me ajetin e cekur se Xheneti dhe Xhehenemi tani nuk ekzistojnë, është i ngjashëm me thirrjen e vëllezërve tuaj në të njëjtin ajet kur flasin për kalueshmërinë e Xhenetit dhe Xhehenemit, shkatërrimit të tyre dhe vdekjes së banorëve të tyre. Prandaj, as ju e as vëllezërit tuaj nuk e keni kuptuar mirë këtë ajet. Këtë ajet më së miri e kanë kuptuar gjeneratat e para të muslimanëve. Ne do t'i cekim vetëm disa komentime të tyre që kanë të bëjnë me këtë ajet:

Buhariu në *Sahihun* e tij thotë: "Me ajetin nënkuptohet: *'Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij'* - pra, përveç sundimit të Tij. Disa thonë: Pos atyre veprave me të cilat është dashur të arrihet kënaqësia e Tij".

Imam Ahmedi, sipas rrëfimit të El-Istahriut, thotë: "Këto janë qëndrimet e dijetarëve, njohësve të hadithit, pasuesit e Sunetit, të atyre që ishin afër kohës së sahabëve të Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, e deri në ditët e sotit. Edhe dijetarët e Hixhazit, Shamit dhe krahnave tjera të cilët i kam mbajtur mend e kanë pasur këtë qëndrim.

Kush nuk pajtohet me diç prej këtyre qëndrimeve ose i kritikon, është kundërvajtës, bidatçi, ai i cili ka braktisur Sunetin dhe rrugën e vërtetë". Mandej i përmend mendimet dhe thotë:

"Xheneti dhe ajo që në të është krijuar, Xhehenemi dhe ajo që në të gjithashtu është krijuar, i ka krijuar Allahu i Lartësuar, dhe i ka krijuar krijesat që do të vendosen në to, dhe asnjëherë nuk do të zhduken ato, e as ata që janë (vendosur) në to. E nëse ndonjë bidatçi ose përçarës thirret në ajetin e Allahut të Lartësuar: *Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij*, apo ajete të tilla që nuk janë aq të qarta, do t'i thuhet: *Çdo gjë që Allahu e ka bërë të kalueshme dhe të zhdrukshme, do të zhdrukët. Xheneti dhe Xhehenemi janë krijuar për amshueshmëri dhe i takojnë botës së ardhshme e jo kësaj. Hyritë e Xhenetit nuk do të vdesin në Ditën e Gjykimit, pasi që t'i fryhet surit e as që do të vdesin ndonjëherë, sepse Allahu i ka krijuar për amshueshmëri dhe nuk i ka bërë që të vdesin. Kush e përgënjeshtron këtë është bidatçi dhe ka devijuar nga rruga e drejtë".*

KAPITULLI I DYTË

DIVERGJENCA NË MENDIME MES NJERËZVE PËR
XHENETIN NË TË CILIN U VENDOS ADEMI, ALEJHI
SELAM

Mundhir ibën Se'idi në tefsirin e tij thotë: "Duke i komentuar fjalët e Allahut të Lartësuar drejtuar Ademit, alejhi selam:

﴿ وَقُلْنَا يَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ ... ﴾

'O Adem, ti dhe bashkëshortja juaj banoni në Xhenet'⁶, një grup dijetarësh thonë: Allahu e ka vendosur Ademin në Xhenetin e përjetësisë, në të cilin besimtarët do të hynë në Ditën e Gjykimit. Të tjerët thonë: Ai ka qenë tjetër Xhenet, Allahu e ka krijuar, e ka vendosur në te vetëm Ademin. Pra, nuk ka të bëjë me Xhenetin e përjetshëm". Mundhiri mëtej thotë: "Ekzistojnë shumë argumente që e forcojnë këtë mendim, respektivisht që e sugjerojnë".

El-Maverdiu në tefsirin e tij thotë se njerëzit janë ndarë në mendime për Xhenetin në të cilin janë vendosur Ademi dhe Hava, alejhimia selam, dhe në këtë kuptim kanë marrë dy qëndrime:

Qëndrimi i parë është se ka të bëjë me Xhenetin e përjetshëm, kurse tjetri është se ka të bëjë me Xhenetin të cilin Allahu e ka përgatitur vetëm për Ademin dhe Havën, duke e bërë vend të sprovimit, e jo me Xhenetin e përjetshëm të cilin Allahu e ka bërë vend të shpërblimit.

Ata që marrin qëndrimin e dytë edhe mëtej ndahen dhe përfaqësojnë dy mendime:

Mendimi i parë është se ai Xhenet gjendet në qiell, sepse Allahu, subhanehu ve teala, Ademin dhe Havën i zbriti prej tij - ky është qëndrimi i Hasanit. **Mendimi i dytë** është se ai gjendet në Tokë, sepse Allahu, subhanehu ve teala, i vuri në sprovë në te duke ua ndaluar t'u afrohen një dru-ri, derisa frytet e drunjëve tjerë i kishin të lejuara - ky është mendim i Ibën Bahrit.

Ibnu'l-Hatibi në tefsirin e tij të njohur thotë: "Dijetarët kanë qëndrime të ndryshme për Xhenetin që është cekur në këtë ajet - se a ka qenë në tokë apo në qiell? Nëse ka qenë në qiell - a është ai Xheneti i përjetshëm dhe i shpërblimit apo është ndonjë Xhenet tjetër?".

Ebu'l-Kasim el-Behli dhe Ebu Muslim el-Asbehani thonë: "Ky Xhenet është në Tokë". Qëndrimin e tyre e mbështetin në ate se *ihbat* do të thotë *intikal* (transferim prej një vendi në vend tjetër), siç është rasti me fjalët e Allahut të Lartësuar: "Zdirgjuni pra në qytet". Edhe Ebu Hanife është i këtij mendimi.

Sipas mendimit të dytë që e përfaqëson El-Xhibai, ky Xhenet ka qenë në qiellin e shtatë.

Sipas mendimit të tretë, të cilin e përfaqësojnë shumica e mendimtarëve tanë, ky Xhenet është vendi i shpërblimit. Këtë mendim e pranon edhe Ebu Isa er-Rumanij dhe thotë: "Ky është qëndrim i Hasanit, Vasilit dhe shumicës së autoriteteve tanë".

Sipas mendimit të katërt, të gjitha mundësitë janë të hapura, kurse argumentet kundërshtohen, kështu që është e nevojshme më tepër të përqendrohemi në këtë çështje, e jo të kalojmë aq lehtë nëpër të. Ebu Zejd el-Malikij thotë: "E kam pyetur Ibën Nafi'un për Xhenetin, a është krijuar ai, e ai është përgjigjur: 'Heshtja në këtë rast është më e mirë...'. Këtë e ka thënë Ibën Ujejne duke folur për fjalët e Allahut të Lartësuar: "Në te as nuk do të uritësh, e as nuk

⁶ El-Bekare: 35.

do të jesh i zhveshur". Ai konsideron se Xheneti në të cilin ka qenë i vendosur Ademi, alejhi selam, ka qenë në Tokë. Përndryshe, Ibën Nafi'u dhe Ibën Ujejne kanë qenë njerëz autoritativ në shkencë".

Ibnu'l-Hatibi përfundon: "Ne nuk kemi thënë gjë pos qëndrimeve të përmendura. Dhe nëse Xheneti në të cilin ka qenë i vendosur Ademi, alejhi selam, ka qenë Xheneti i amshueshëm, amshueshmëria është në te. Ne jemi orientuar në përputhshmëri me ajetet kur'anore, derisa disa tjerë janë orientuar me diç që nuk është bazuar në argumente të forta. Ne do t'i paraqesim edhe argumentet e dy grupeve (që janë ndarë në këtë çështje, vër. e përkth.) dhe nëse don Allahu, do t'i shpjegojmë se çka u shkon në favor, dhe çka i demanton ato".



KAPITULLI I TRETË

ARGUMENTET E DY GRUPEVE, ARGUMENTET QË JANË NË FAVOR TË TYRE DHE ATO QË I DEMANTOJNË ATA

Argumentet e atyre që konsiderojnë se bëhet fjalë për Xhenetin e përjetshëm

Thonë: Ajo që ne e themi është ajo që Allahu e ka mbjellur në vetë natyrën njerëzore, ashtu që njerëzve edhe nuk u bie ndërmend asgjë tjetër. Madje shumica e tyre edhe nuk dinë se ekziston ndonjë kundërshtim. Thonë: Muslimi ka shënuar në *Sahihun* e tij nga Ebu Hurejra dhe Hudhejfeja se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Allahu i Lartësuar do t'i tubojë njerëzit, besimtarët do të qëndrojnë derisa nuk u afrohet Xheneti, dhe Allahu do ta sjellë Ademin, alejhi selam, dhe do të thonë: *O babai ynë, na e hap Xhenetin*. Ai do të thotë: *A nuk ju ka nxjerrur prej Xhenetit pikërisht mëkati i babait juaj?..."* Muslimi e citon hadithin deri në fund. Ky hadith udhëzon në atë se Xheneti, prej të cilit Allahu, subhanehu ve teala, e ka nxjerrur Ademin, alejhi selam, është i njëjti për të cilin besimtarët do të kërkojnë prej Ademit, alejhi selam, t'ua hapë.

Në veprat e hadithit, të Buhariut dhe Muslimit, është regjistruar hadithi që flet për kontestin mes Ademit dhe Musait ku mes tjerash Musai, alejhi selam, thotë: "Ti dhe nxitja (shpejtimi) yte na keni nxjerrur prej Xhenetit". Prandaj, sikur ai Xhenet të kishte qenë në Tokë, ata në këtë rast do të dilnin vetëm prej bahçeve (kopshteve) e jo prej vetë Xhenetit.

Në suren Bekare thuhet:

﴿ فَأَزَلَّهُمَا الشَّيْطَانُ عَنْهَا فَأَخْرَجَهُمَا مِمَّا كَانَا فِيهِ وَقُلْنَا اهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ وَلَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ ﴾

"Pastaj shejtani i bëri ata të rrëshqasin që atje (prej Xhenetit) dhe i nxorri ata prej atje ku qenë. Ne thamë: 'Zbritni poshtë të gjithë ju me armiqtësinë mes jush! Në tokë do të jetë banesa dhe jetesa juaj e përkohshme'.⁷ Ky ajet nga dy aspekte tregon se zbritja e tyre ka qenë prej Xheneti në Tokë.

Aspekti i parë është se shprehja *ihbitu* që do të thotë zbritje prej një pozite më të lartë në pozitë më të ulët. Aspekti i dytë është se fjalët "Në tokë do të jetë banesa dhe jetesa juaj" vijnë pas fjalës "zbritni", që tregon se ata më parë nuk kishin qenë në Tokë. Kjo vërtetohet edhe me ajetin e sures A'raf:

﴿ قَالَ فِيهَا تَحْيَوْنَ وَفِيهَا تَمُوتُونَ وَمِنْهَا تُخْرَجُونَ ﴾

"Ai u tha: Atje do të jetoni dhe atje do të vdisni dhe prej saj do të nxirreni përsëri pastaj (në ringjallje)".⁸ Sikur Xheneti të ishte në Tokë, ata do të jetonin në te edhe para edhe pas daljes prej tij.

Allahu, subhanehu ve teala, e ka përshkruar Xhenetin e Ademit, alejhi selam, me karakteristikat që i ka vetëm Xheneti i amshueshëm, duke thënë:

﴿ إِنَّ لَكَ أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَىٰ ۖ وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَضْحَىٰ ﴾

"Sigurisht që ke (premtim prej Neshi) se nuk do të kesh kurrë uri atje dhe nuk do të jesh i zhveshur. Nuk do të vuash atje as nga etja dhe as nga nxehtësia e diellit".⁹ Kjo

nuk mund të jetë në këtë botë, sepse edhe sikur njeriu të ishte në banesën më të mirë në Tokë, prapsepapë diç nga kjo do ta kishte goditur.

Allahu i Lartësuar në ajetin e sipërpërmendur, urinë dhe etjen e ka vendosur përballë zhveshjes dhe nxehtësisë. Uria është vështirësi e brendisë së njeriut, kurse nxehtësia është vështirësi e të jashtmes së tij. Prandaj Allahu, subhanehu ve teala, prej banorëve të Xhenetit i ka larguar vështirësitë e të brendshmes dhe jashtmes së tij - ky është shpërblim që u takon banorëve të Xhenetit të amshueshëm.

Sikur Xheneti të ishte në këtë botë, Ademi, alejhi selam, do ta dinte se Iblisi nuk e flet të vërtetën kur i ka thënë:

﴿ ... يَا آدَمُ هَلْ أَدُلُّكَ عَلَىٰ شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ لَّا يَبْلَىٰ ﴾

"O Adem! A të të çoj te Pema e Perjetësisë dhe te një mbretërim që kurrë nuk do të shterojë?".¹⁰ Ademi, alejhi selam, e ka ditur se kjo botë është e kalueshme dhe se pushteti në te nuk është i përjetshëm.

Fjala *Xhenet* vjen me nyje të shquar në çdo vend, si p.sh., në fjalët e të Lartësuarit:

﴿ وَقُلْنَا يَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ... ﴾

"O Adem! Bano ti dhe bashkëshortja yte në Xhenet..."¹¹, dhe shembuj të ngjashëm. Ata të cilëve u drejtohem nuk dinë për asnjë Xhenet tjetër pos për Xhenetin e përjetësisë të cilin i Gjithëmëshirshmi ua ka premtuar robërve të Tij në botën e ardhshme. Emri *Xhenet* është bërë i njohur për të gjithë, prandaj kudo që është cekur, me

⁷ El-Bekare: 36.

⁸ El-A'raf: 25.

⁹ Ta-Ha: 118, 119.

¹⁰ Ta-Ha: 120.

¹¹ Bekare: 35.

kuptimin e tij udhëzon në Xhenetin për të cilin dinë zemrat e besimtarëve.

Sikur me këtë shprehje të mendohej në ndonjë Xhenet tjetër, në atë rast ai do të përmendej në formë të pashquar, do të ishte lidhur me ndonjë prapashitesë ose kontest që do të udhëzonte në ate se ka të bëjë me Xhenetin në Tokë. Rastin e parë e kemi në fjalët e Allahut, subhanehu ve teala:

﴿... جَعَلْنَا لِأَحَدِهِمَا جَنَّتَيْنِ مِنْ أَعْنَابٍ...﴾

"...dy kopshte me vreshta".¹² Rasti i dytë është prezent në fjalët e Tij:

﴿وَلَوْلَا إِذْ دَخَلْتَ جَنَّتَكَ قُلْتَ...﴾

"E pse ti kur hyre në kopshtin tënd..."¹³, derisa të tretin e kemi në fjalët e Tij:

﴿إِنَّا بَلَوْنَاهُمْ كَمَا بَلَوْنَا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ إِذْ أَقْسَمُوا لَيَصْرِمُنَّهَا مُصْبِحِينَ﴾

"Ne i sprovuam ata (mekasit) sikurse i kemi pas sprovuar pronarët e kopshtit".^{14 15}

Argumentet e atyre që konsiderojnë se bëhet fjalë për Xhenetin në Tokë

Thonë: "Allahu, subhanehu ve teala, na ka lajmëruar nëpërmjet të dërguarve të Tij se në Xhenetin e përjetesisë do të hyhet në Ditën e Gjykimit, dhe se koha e hyrjes në te ende nuk ka ardhur".

¹² El-Kehf: 32.

¹³ El-Kehf: 39.

¹⁴ El-Kalem: 17.

¹⁵ Në këto ajete fjala xhenet është përkthyer si "kopsht" dhe është përcaktuar me atribut të veçantë

Thonë: "Allahu, subhanehu ve teala, e ka përshkruar Xhenetin që është përgatitur si vendbanim për të devotshmit (*Daru'l-mukameh*), prandaj ai që hyn aty do të vendoset përgjithmonë, kurse Ademi nuk ka mbetur përgjithmonë në te. E ka përshkruar, po ashtu si vend i të mirës dhe shpërblimit, e jo i borxhit, urdhërave dhe ndalesave, dhe si vend shpëtimi, e jo sprovash dhe provimesh, kurse Ademi u sprovua në te me një sprovë të madhe. E ka përshkruar edhe si vend ku askush asnjëherë nuk do t'i kundërshtojë urdhërat e Allahut, kurse Ademi ishte i padëgjueshëm ndaj Zotit të tij në Xhenetin në të cilin kishte hyrë. E ka quajtur *Shtëpi e paqes-shpëtimit* (*Daru's-selam*), kurse Ademi dhe Hava në te nuk kishin shpëtuar prej mëkatit. Për ata që hynë në te, Ai, subhanehu ve teala, thotë:

﴿لَا يَمَسُّهُمْ فِيهَا نَصَبٌ وَمَا هُمْ مِنْهَا بِمُخْرَجِينَ﴾

'Ata aty nuk i godet kurrfarë lodhje dhe nuk do të nxirren kurrë prej tij'.¹⁶ Kurse prej tij i nxorri Ademin, alejhi selam, dhe Havën. Për Xhenetin, Allahu, subhanehu ve teala, po ashtu thotë:

﴿يَتَنَزَّعُونَ فِيهَا كَأَسَا لَأَنعَوْ فِيهَا وَلَا تَأْتِيهِمْ﴾

'...aty nuk ka fjalë të kota e as mëkat'.¹⁷ Kurse Ademi ka dëgjuar në te fjalë të kota nga Iblisi dhe e ka nxitur në mëkate. Allahu, subhanehu ve teala, Xhenetin e ka quajtur Shtëpi të sinqeritetit (*Mak'adu sidk*), kurse Iblisi ka gënjyer në te dhe është betuar në rrenën e tij".

Thonë: "Allahu i Lartësuar u ka thënë melekëve:

﴿... إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً...﴾

¹⁶ El-Hixhër: 48.

¹⁷ Et-Tur: 23.

'Unë po krijoj (po përcajtoj) në tokë një zëvendës'¹⁸ e nuk ka thënë: 'Unë po krijoj (po përcajtoj) në Xhenet një zëvendës'. Melekët i thanë të Lartësuarit:

﴿... قَالُوا أَنَحْنُلُ فِيهَا مَن يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ...﴾

'...A do të vësh në te atë që bën çrregullime dhe që derdh gjacket...'¹⁹. Është absurde që kjo të ndodhë në Xhenet".

Thonë: "Nuk ka kundërshti rreth asaj se Allahu, subhanehu ve teala, e ka krijuar Ademin në Tokë, por askund nuk është cekur se pas kësaj Ai e ka ngritur në qiell. Sikur Allahu, subhanehu ve teala, ta kishte bërë këtë, me siguri do ta kishte përmendur (në Kur'an, vër. e përkth.), sepse kjo do të ishte një prej shenjave më të mëdha të Allahut. Kjo do të thonte se Ademi, alejhi selam, është ngritur, me trup dhe shpirtë, prej Toke mbi qiej".

Thonë: "Është e ditur se ajo që gjindet mbi qiej nuk është vend i përshtatshëm për glinën tokësore të ndryshueshme, e cila gjatë ndryshimit të gjendjes së saj fiton një aromë të papërshtatshme, se (në fakt) vendi i saj është në tokë".

Thonë: "Kur të mirret parasysht gjithë ajo që ka thënë Allahu, subhanehu ve teala: se e ka krijuar Ademin prej toke dhe e ka bërë zëvendës në Tokë, se Iblisi e ka nxitur në mëkat në vendin të cilin Allahu e ka vendosur për të banuar pasi që e zbriti prej qiellit, për shkak se nuk bëri sexhde (Ademit, a.s.), se Allahu i ka lajmëruar melekët se do të krijojë zëvendës në Tokë, se Xheneti i amshueshëm është vend i shpërblimit dhe sevapit, e jo i borxhit dhe sprovave, se në atë Xhenet nuk ka biseda të kota, nxitje në mëkate, as rrena, se ai që hyn në te, nuk do të del prej tij, nuk do të jetë i pikëlluar, nuk do të frikohet dhe dëshpro-

¹⁸ El-Bekare: 30.

¹⁹ El-Bekare: 30.

het, nuk do të flejë, se Allahu ua ka ndaluar mosbesimtarëve, kurse Iblisi është prijës i mosbesimtarëve - kur të gjithë këto argumente të bashkohen dhe kur rreth këtyre të mendon ai që s'mban anë (është neutral në qëndrimet e tij), dhe udhëzohet me to dhe ruhet nga devijimi dhe pasimi i verbër (*takliidi*), do të kuptojë se ky qëndrim është i drejtë, kurse Allahu e din se kush është në të drejtë".



KAPITULLI I KATËRT

DYERT E XHENETIT

Numri i dyerve të Xhenetit

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar hadithi i Ebu Hazmit të cilin e transmeton nga Sehël ibën Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Xheneti i ka tetë dyer, njëra prej tyre quhet Er-Rejan, dhe në te do të hyjnë vetëm agjëruesit".

Në të njëjtat përmbledhje të haditheve nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, është shënuar se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ai që shpenzon dy lloje të pasurisë së tij në rrugën e Allahut, do të thirret nga të gjitha dyert e Xhenetit dhe ai ka tetë dyer. Ai që është prej namazltove, thirret nga dera e namazit, ai që është nga ata që shpenzojnë (japin lëmoshë), thirret nga dera e sadakasë, muxhahidi do të thirret nga dera e xhihadit dhe ai që është nga agjëruesit do të thirret nga dera e agjërimit". Ebu Bekri, radijallahu anhu, ka thënë: "Vallahi nuk ka dëm për asnjë prej cilësdo derë që thirret, por a thirret ndonjëri nga të gjitha ato, o i Dërguar i Allahut?". Tha: "Po, dhe shpresoj që ti do të jesh nga ata".

Në Sahihun e Muslimit ceket se Omer ibën Hatabi, radijallahu anhu, ka thënë: "Kush merr abdest mirë, pastaj thotë: 'Eshhedu en lā Ilāhe il-Allāhu vahdehu lā sherike lehu ve esh-hedu ene Muhameden abduhu ve resūluhu' (Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një, i vetëm dhe i pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, është rob dhe i Dërguar i Tij) i hapen të gjitha dyert e Xhenetit dhe do të hyjë prej cilësdo të dëshirojë ai". Tirmidhiu pas dëshmisë shton: "Allahume-xh-alni minet-tevábine ve-xh-alni

minel-mutetahirin, (O Zoti im, më bëj mua prej atyre që pendohen dhe më bëj mua prej atyre të cilët pastrohen)". Ebu Davudi dhe Imam Ahmedi i shtojnë fjalët: "Pastaj ngre shikimin e tij në qiell dhe thotë...".

Imam Ahmedi ka shënuar transmetimin nga Enesi, radijallahu anhu, të cilin ai e lidhë me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem: "Kush merr abdest mirë, pastaj thotë tri herë: 'Esh-hedu en lā Ilāhe ilallāhu vahdehu lā sherike lehu ve esh-hedu ene Muhameden abduhu ve resūluhu' (Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një, i vetëm dhe i pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, është rob dhe i Dërguar i Tij), i hapen të gjitha dyert e Xhenetit dhe do të hyjë prej cilësdo të dëshirojë ai".

Ibën Maxheja ka shënuar se Ibën Utbe ibën Abdullah es-Sulemi ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, se ka thënë: 'Secilit musliman që i vdesin tre fëmijë para se të hynë në bylyk (pubertet, moshë madhore), i hapen të gjitha dyert e Xhenetit dhe do të hyjë prej cilësdo të dëshirojë ai'".

Madhësia e dyerve të Xhenetit

Transmetohet nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se ka thënë: "Në duart e Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, gjindej një pjatë me papare (përseshesh) dhe mish, e mori shpatullën, dhe kjo ishte pjesa më e dashur e mishit të deles, e kafshoi fortë dhe tha: 'Unë do të jem njeriu i parë që do të ringjallet në Ditën e Gjykimit'. Pastaj e kafshoi për herë të dytë dhe përsëriti: 'Unë do të jem njeriu i parë që do të ringjallet në Ditën e Gjykimit'. Kur vërejt se askush prej sahabëve nuk e pyeti asgjë tha: 'Pse nuk po më pyetni se si?'. Ata e pyetën: 'Si o i Dërguar i Allahut?'. Ai u përgjigj: 'Njerëzit do t'i kthehen Zotit të botëve, dhe Ai do të bëjë që ata t'i dëgjojnë zërat që do t'i thërrasin, dhe shikimin do t'ua bëjë të mprehtë!', pastaj e citoi hadi-

thin mbi shefatin (ndërmjetësimin) në tërësi dhe në fundin e tij tha: 'Pastaj do të nisem dhe do t'i afrohem Arshit, do t'i bëj sexhde Zotit tim, e Zoti do të më jep pozitë që nuk i është dhënë askujt më parë dhe nuk do t'ia jep askujt pas meje. Pastaj unë do të them: 'O Zoti im, pasardhësit e mi, pasardhësit e mi. Zoti do të thotë: O Muhamed, futi nga pasardhësit e tu ata që nuk do të japin llogari në derën e djathtë, ata do t'u bashkagjiten njerëzve që kanë hyrë nga dyert tjera. Pasha Ate në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, vërtetë largësia mes dy krahëve të dyerve të Xhenetit është sikur largësia mes Mekes dhe Hexherit²⁰ ose Mekes dhe Basrës'.²¹ (Ekziston pajtueshmëri për autenticitetin e këtij hadithi).

Në hadithin e cekur nuk ka kundërthënie, dobësi të fshehur e as parregullsi. Ka edhe transmetime tjera në këtë temë, por janë apokrifë dhe të dobëta.

Pasuesit e Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, do të kenë dyert e tyre nga të cilat, përveç popujve tjerë, do të hynë në Xhenet. Kështu në *Musnedin* e Ahmedit nga Ibën Omeri është shënuar se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Dyert nga të cilat do të hyjë umeti im janë të gjëra sa tri ditë kalërim (udhëtim), ata do të shtyhen duke hyrë në to saqë gati se do të mbesin pa krahë duke u shtyrë!".

Taberaniu transmeton se Lukajt ibën Amiri ka dalë dhe ka shkuar te i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem. Ka thënë: "E pyeta: 'O i Dërguar i Allahut, çka janë Xheneti dhe Xhehenemi?'. Pejgamberi u përgjig: 'Allahu të dhashtë jetë, Xhehenemi i ka shtatë dyer, në mes të çdo dy dyerve, udhëtari do të udhëtonte shtatëdhjetë vjet, kurse Xheneti i ka tetë dyer, dhe mes dy dyerve udhëtari do të udhëtonte shtatëdhjetë vjet'".

Këtu bëhet fjalë për largësinë mes dy dyerve, sepse gjërësia e njëres derë, që u përcaktua me largësinë mes Mekes dhe Basrës, nuk i përgjigjet kësaj largësie.

²⁰ Rajon në Bahrejn.

²¹ Vend në Sirinë jugore.

KAPITULLI I PESTË

KU GJENDET XHENETI?

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَلَقَدْ رَأَوْا نَزْلَةَ أُخْرَىٰ ۖ عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَىٰ ۖ عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ﴾

"Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) Tek Sidretul Munteha. Që pranë saj është Xhenetul Me'va".²² Është vërtetuar se Sidretul Munteha gjendet mbi qiej, dhe është quajtur ashtu, sepse ai është kufiri i fundit deri te i cili arrin ajo që arrin deri te Allahu dhe prej aty mirret, si dhe ajo që ngritet te Ai prej aty mirret.

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

﴿وَفِي السَّمَاءِ رِزْقُكُمْ وَمَا تُوعَدُونَ﴾

"E në qiell është furnizimi juaj dhe ajo që ju premtohet".²³ Ibën Ebi Nexhih, duke u thirrur në Muxhahidin, thotë: "Këtu ka për qëllim Xhenetin". Kështu njerëzit e kanë pranuar këtë prej tij.²⁴ Ibnu'l-Mundhiri në tefsirin e tij, si dhe disa autorë tjerë, kanë shënuar transmetimin nga Muxhahidi ku thotë: "Këtu ka për qëllim Xhenetin dhe Xhehenemin".²⁵ Ky mendim kërkon komentim, sepse Xhehenemi gjendet në sferën më të ulët, e jo në qiell.

Kuptimi i mendimit të cekur gjendet në transmetimin e Ibën Ebi Nexhihut dhe transmetimin të cilin Ebu Salihu e transmeton nga Ibën Abasi. Domethënë: "Edhe e mira

²² En-Nexhm: 13-15.

²³ Edh-Dharifat: 22.

²⁴ Ed-Darru'l-mensur, 198/4.

²⁵ Ibid.

edhe e keqja vjen nga qielli". Sipas kësaj, supozimet e Xhenetit dhe Xhehenemit në dimenzionin konstant gjenden në qiell; rrjedhin nga Allahu, subhanehu ve tealà.

Ebu Ne'imi ka regjistruar se Abdullah ibën Selami ka thënë: "Krijesa më fisnike të cilën e ka krijuar Allahu është Ebu'l-Kasimi, kurse Xheneti gjendet në qiell". Nga Ibën Abasi transmetohet se ka thënë: "Xheneti gjendet mbi katin e shtatë të qiellit dhe Allahu në Ditën e Gjykimit do ta vendosë ku të dëshirojë Ai, kurse Xhehenemi në tokën e shtatë".²⁶

Ibën Mendehu ka regjistruar se Ibën Mes'udi ka thënë: "Xheneti është në qiellin e katërt, e kur të vie Dita e Gjykimit, Allahu, subhanehu ve tealà, do ta vendosë ku të dëshirojë Ai, kurse Xhehenemi është në tokën e shtatë, e kur të vie Dita e Gjykimit, Allahu, subhanehu ve tealà, do ta vendosë ku të dëshirojë Ai".²⁷

Muxhahidi thotë: "E kam pyetur Ibën Abasin se ku është Xheneti", e ai është përgjigjur: "Mbi shtatë qiej". E kam pyetur: "E ku është Xhehenemi?". Ai ka thënë: "Nën shtatë shtresa të deteve".²⁸

Në *Salih* është shënuar: "Kur të kërkonit prej Allahut, kërkonit prej Tij Xhenetin Firdeus, sepse ai është qendra dhe Xheneti më i lartë, mbi të është Arshi (froni) i Gjithëmëshirshmit, e mbi të lumejt e Xhenetit". Mësuesi ynë, Ebu'l-Haxhaxh el-Murrij, thotë: "I drejtë është shënimi i atyre që transmetojnë (ر. ن. ه) - maja e tij me dame në shkronjën "f", si emër, e jo parafjalë. Kjo do të thotë se kulmi i Firdeusit është froni i Gjithëmëshirshmit".

²⁶ Ebu Ne'im, *El-Mustahrexi*, fq. 465.

²⁷ Hafidh Ismail el-Isfehani, *Sijeru's-selefi's-salihin*, fq. 302.

²⁸ *Ed-Darru'l-mensur*, 199/4.

KAPITULLI I GJASHTË

ÇELËSI I XHENETIT

Imam Ahmedi në *Musnedin* e tij ka shënuar nga Mu'adh ibën Xhebeli: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Çelësi i Xhenetit është dëshmia se nuk ka zot tjetër pos Allahut".

Buhariu në *Sahihun* e tij ka shënuar nga Vehb ibën Munebehu se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, është pyetur: "A nuk është çelësi i Xhenetit dëshmia se nuk ka zot tjetër pos Allahut?". Ai është përgjigjur: "Sigurisht, por çdo çelës i ka dhëmbët dhe nëse e sjell çelësin i cili ka dhëmbë, do të të hapet Xheneti, e nëse nuk e sjell nuk do të hapet".

Ebu'sh-Shejhu transmeton se Jezid ibën Suhberi ka thënë: "Shpatat janë çelësa të Xhenetit".²⁹

Në *Musnedin* e Ahmed ibën Hanbelit transmetohet hadithi nga Mu'adh ibën Xhebeli, radijallahu anhu: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: A dëshiron të të udhëzoj në njërën nga dyert e Xhenetit? I thashë: 'Sigurisht!'. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, tha: (Ato janë fjalët) *La havle ve la kuvete ila bilah* (S'ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut)".

Ebu Ne'imi transmeton nga Enesi, radijallahu anhu: "Ka pyetur një beduin (fshatar): 'O i Dërguar i Allahut, ç'është çelësi i Xhenetit?'. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, iu përgjigj: (Fjalët) *Nuk ka zot pos Allahut*".

²⁹ Thënien e ka regjistruar Ibnu'l-Mubareku nga Jezidi në *Kitabu'l-xlihad*, fq. 36.

Shfrytëzimi i portave (dyerve) të diturisë

Allahu, subhanehu ve teala, për çdo obligim ka caktuar çelës me të cilin ai hapet: çelës i namazit është pastërtia, çelës i haxhit është ihrami, çelës i bamirësisë është sinqeriteti, çelës i Xhenetit është pranimi i njëshmërisë së Allahut, çelës i diturisë është pyetja e mirë, çelës i fitores është durimi, çelës i rritjes së furnizimit është falënderimi, çelës i shoqërisë është dashuria dhe kujtimi, çelës i dëshirës për Ahiret është modestia në dynja, çelës i besimit është përkujtimi i asaj që Allahu dëshiron që rob i Tij të përkujtohet (dhikri), çelës i ngjalljes së zemrës është meditimi mbi ajetet kur'anore, të drejtuarit kah Allahu, fshehurazi në orët e hershme të mëngjesit dhe lënia e mëkateve, çelësi i furnizimit është munda dhe kërkimi falje nga Allahu, çelës i fuqisë është nënshtrimi ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij, salallahu alejhi ve selem, kurse çelës i përgatitjes për botën e ardhshme është mosmbështetja në shpresën e shkrete.

Përdorimi i dyerve të diturisë është temë shumë e rëndësishme, sepse këtu bëhet fjalë për njohjen e çelësit e së mirës dhe së keqes. Allahu i Lartësuar, me fjalë tjera, ka caktuar për çdo të mirë dhe të keqe çelës dhe derë të caktuar, kështu për shembull, politeizmin dhe kryelartësinë e ka bërë çelës të Xhehenemit, alkoolin çelës të çdo mëkati, muzikën çelës të imoralitetit, përtacinë çelës të mossuksesit dhe privimit, gabimin çelës të mosbesimit, kurse ngurtësinë çelës të koprracisë dhe ndërprerjes së lidhjeve familjare.

Prandaj, njeriu duhet të përkushtojë kujdes të madh në njohjen e çelsave dhe asaj se për çka janë dedikuar, kurse Allahu, subhanehu ve teala, qëndron pas suksesit dhe drejtësisë së Tij, Atij i takojnë pushteti, falënderimi, mirënjohjet dhe bekimet.

KAPITULLI I SHTATË

VETËM NJË RRUGË ÇON NË XHENET

Të gjithë pejgamberët ishin të pajtimit në këtë, prej të parit e deri te i fundi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi gjithë ata! Mirëpo, për në Xhehenem ka më shumë rrugë se sa mundet të konfirmohen. Prandaj, Allahu, subhanehu ve teala, ka caktuar vetëm një rrugë për në Xhenet, kurse shumë rrugë për në Xhehenem. Në këtë kuptim Ai thotë:

﴿ وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَالْبَعُورُ وَلَا تَتَّبِعُوا السَّبِيلَ فَتَفْرَقَ بَيْنَكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴾

"Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij".³⁰

Allahu, subhanehu ve teala, po ashtu thotë:

﴿ وَعَلَى اللَّهِ قَصْدُ السَّبِيلِ وَمِنْهَا جَائِرٌ وَلَوْ شَاءَ لَهَدَاكُمْ أَجْمَعِينَ ﴾

"Udhëzimi për në rrugë të drejtë i takon Allahut e ka edhe rrugë që është e shtrembër".³¹ Domethënë se ka rrugë që të largon nga qëllimi, e ajo është rruga e devijimit.

Ibën Mes'udi thotë: "Na e vizatoi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, një vijë të drejtë dhe tha: *Kjo është rruga e Allahut*. Pastaj vizatoi disa vija në të djathtë dhe të majtë të asaj vije të drejtë dhe tha: *Këto janë rrugica tjera,*

³⁰ El-En'am: 153.

³¹ En-Nahel: 9.

dhe në çdonjërin prej tyre ka nga një shejtan që thërret në ato rrugica. Mandej lexoi:

﴿ وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السَّبِيلَ فَتَفْرَقَ بَيْنَكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكَكُمْ وَأَصَابَكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴾

Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij".³²

Nëse ndokush pyet: "Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿... قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴿١﴾ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ... ﴾

"Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij".³³, do t'i përgjigjet: "Ato janë rrugët të cilat - të gjitha ato - gjenden në një shteg; ato janë sikur kuajt e garave dhe shtigjet e tyre; të gjitha ato gjinden në një shteg të madh; ato vërtetë janë rrugët e degëve të besimit të cilat ai i bashkon siç i bashkon trungu i drurit degët dhe nëndegët e saja".

Këto rrugë nënkuptojnë të përgjigjurit rrugës së Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, të besuarit në atë që ai ka lajmëruar dhe të nënshtruarit në atë që ai ka urdhëruar, kurse rruga për Xhenet pikërisht është të përgjigjurit atij që thërret në te, nuk ka rrugë tjetër deri te ai (Xheneti).

Buhariu në *Sahihun* e tij ka shënuar se Xhabiri ka thënë: "I kanë ardhur melekët Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, e disa prej tyre thanë: 'Ai po flenë'. Të tjerët thanë: 'Sytë po flejnë, por zemra është e zgjuar'. Mandej thanë: 'Ky nikoqiri juaj është një shembull, pra

tregojeni'. Thanë: 'Ai është sikur njeriu që e ndërton një shtëpi dhe bën gosti, mandej e dërgon lajmëtarin dhe ai që i përgjigjet lajmëtarit, do të hyjë në shtëpi dhe do të hajë në gosti'. Melekët tjerë thanë: 'Shpjegojani këtë, që ta dijë'. Mandej disa prej tyre thanë: 'Sytë flejnë, kurse zemra është e zgjuar; shtëpia është Xheneti, kurse lajmëtari është Muhamedi, salallahu alejhi ve selem. Ai që i nënshtrohet Muhamedit i është nënshtruar edhe Allahut, e ai që nuk i nënshtrohet Muhamedit, nuk i nënshtrohet as Allahut. Muhamedi është ndarës i njerëzve".

Tirmidhiu ka shënuar transmetimin e Xhabirit ku ai thotë: "Allahu është Sundues, shtëpia është Islami, banesa është Xheneti, kurse ti, o Muhamed je i dërguar, ai që i përgjigjet thirrjes tënde, do të hyjë në Islam, e ai që hyn në Islam, do të hyjë në Xhenet, dhe ai që hyn në Xhenet, do të hajë nga ajo që është në të".

Tirmidhiu e ka vlerësuar si autentik hadithin të cilin e transmeton Ibën Mes'udi, ku thuhet: "Allahu e ka ndërtuar Xhenetin dhe i thërret robërit e Tij në te dhe ai që i përgjigjet thirrjes do të hyjë në Xhenet, e ai që nuk i përgjigjet, ate do ta dënojë".



³² El-En'am: 153.

³³ El-Maide: 15, 16.

KAPITULLI I TETË

NIVELET E XHENETIT DHE SHKALLA E TIJ MË E LARTË

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿لَا يَسْتَوِي الْقَاعِدُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ غَيْرُ أُولِي الضَّرَرِ وَالْمُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ عَلَى الْقَاعِدِينَ دَرَجَةً وَكُلًّا وَعَدَ اللَّهُ الْحُسْنَىٰ وَفَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ عَلَى الْقَاعِدِينَ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٣٤﴾ دَرَجَاتٍ مِّنْهُ وَمَغْفِرَةً وَرَحْمَةً وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿٣٥﴾﴾

"Allahu i ka parapëlqyer në shkallë më të lartë ata që përpiqen dhe luftojnë me pasurinë e tyre dhe me jetën e tyre përmbi ata që rrinë në shtëpitë e tyre. Për secilin Allahu ka premtuar mirësi (Xhenet), por Allahu ka parapëlqyer ata që përpiqen dhe luftojnë përmbi ata që rrinë në shtëpi me një shpërblim të madh. Shkallë të larta vlerësimi prej Tij si edhe falje dhe mëshirë. Dhe Allahu është vazhdimisht Falës i Madh, kurdoherë Mëshirëplotë".³⁴

Ibën Xheriri ka shënuar se Ibën Muhajrizi ka thënë: "Fjalët derexhatun minhu (Shkallë të larta vlerësimi prej Tij) nënkuptojnë shtatëdhjetë derexhe (shkallë), kurse mes dy shkallëve largësia është aq sa do të kishte vrapuar kali garrues për shtatëdhjetë vjet".

Ibnu'l-Mubareku thotë se fjalët e Allahut të Lartësuar Lehum derexhetun 'inde Rabilhim (Atyre u takojnë nderimet (derexhet) te Zoti i Tyre) don të thotë: "Disa njerëz do të jenë më të mirë se të tjerët, dhe ai që më tepër është dekoruar (nderuar, dalluar) do ta shohë dekorimin e atij që është

³⁴ En-Nisa: 95, 96.

nën te, kurse ai që do të jetë në shkallë më të ulët se ai nuk do të shohë se ndokush prej njerëzve është dekoruar më tepër se ai".

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

﴿إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَّتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٣٦﴾ الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ ﴿٣٧﴾ أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا لَهُمْ دَرَجَاتٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَمَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ ﴿٣٨﴾﴾

"E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre, të të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe, të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizua, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe furnizim në mënyrë të ndershme".³⁵

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Banorët e Xhenetit i shohin banorët e dhomave lart tyre ashtu sikurse e shohin yllin shndritës të largët në horizonte nga lindja dhe perëndimi, si shkak i dallimit të tyre". Shokët e tij i thanë: "O i Dërguar i Allahut, a janë ato pozitat e pejgamberëve që nuk i arrinë askush tjetër përveç tyre?". Tha: "Assesi, betohem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, aty janë edhe ata burra që besuan në Allahun dhe që i vërtetuan pejgamberët".

Te Buhariu qëndron (në horizont), që është më e qartë. Shprehja gabir tregon ate që shkon, i cili shkon drejt perëndimit të afërt të tij. Me këtë shprehje kihet për qëllim të përmenden dy gjëra: 1. Largësia e atij ylli nga sytë të

³⁵ El-Enfal: 2-4.

cilët e shikojnë; 2. Se Xheneti përbëhet nga shkallë nga të cilat disa janë më të lartë se tjerët edhe ata të lartit nuk qëndrojnë përballë atyre të ultëve, siç janë kopshtet të cilat shtrihen nga maja deri te fundi i malit. Mirëpo, prap, Allahu e di më së miri!

Imam Ahmedi ka regjistruar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Banorët e Xhenetit në Xhenet do të shonin njëri tjetrin siç shihen ju në mes veti ose sikurse e shihni yllin ndriçues duke humbur në horizont dhe duke u paraqitur si shkak i dallimit të tyre". Sahabët e pyetën: "O i Dërguar i Allahut, a janë ato pozitat e pejgamberëve?". Ai u përgjigj: "Assesi, betohem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, aty janë edhe ata burra që besuan në Allahun dhe që i vërtetuan pejgamberët". Buhariu në Sahihun e tij thirret në njerëzit që gjenden në vargun e transmetuesve të këtij hadithi. Në këtë transmetim gjendet fjala *el-garib* derisa në transmetimin e Ebu Se'idit qëndron *el-gabir*, kurse shprehja *et-tali'* është cilësi e yllit, e ka përshkruar sikur ai që del dhe humbet (perëndon).

Në Musned është shënuar nga Ebu Se'idi se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ata që duhen, dhomat e tyre në Xhenet do të duken sikur yjet që paraqiten në lindje ose perëndim". Pejgamberi u pyet: "Kush janë ata?". Pejgamberi u përgjigj: "Ata që duhen në emër të Allahut, subhanehu ve teala".

Pozita më e lartë në Xhenet

Muslimi në Sahihun e tij transmeton se Amër ibu'l-Asi e ka dëgjuar Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: "Kur ta dëgjoni muezinin, thoni sikurse thotë ai, pastaj bini salavat mbi mua (lutuni për mua, Allahume sali ala Muhamedin ve ala ali Muhamed), sepse ai që dërgon mbi mua salavate një herë, Allahu dërgon salavate për te dhjetë herë, pastaj

kërkoni për mua vesilen (pozitën e lartë, ndërmjetësimin), sepse atë që kërkon për mua vesilen, do ta kapë ndërmjetësimi".

Kush e lexon këtë lutje kur ta dëgjojë ezanin: "Allahume rabe hadhihi-da`vetit-tameti ves-salati-l-kaimeti, ati Muhamedi-nini-l-vesilete ve-l-fadilete, veb`ath`hu mekamen mahmudeni-ledhi vead`tehu" (Allahu im, Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe namazit që do të fillojë, jepi Muhamedit ndërmjetësimin dhe nderimin. Ngrite atë në vendin e lavdishëm të cilin ia ke premtuar), atij do t'i lejohet shefa`ati im në Ditën e Kijametit".

Në Musned është shënuar transmetimi nga Ebu Se'idi i cili thotë: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: *El-vesiletu* është një pozitë tek Allahu që nuk ka pozitë më të lartë mbi te, ju luteni Allahun të ma dhurojë mua".

Pozita e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, është quajtur *vesile*, sepse është pozita më afër fronit të Gjithëmshirshmit, d.m.th., më afër Allahut, subhanehu ve teala.

Pasiqë Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, më tepër i ka robëruar Zotit të tij, më tepër e ka njohur, më tepër i ka pasur frikë dhe më shumë e ka dashur, pozita e tij është më afër Allahut dhe kjo është pozita më e lartë në Xhenet. Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, i ka urdhëruar pasuesit e tij që të kërkojnë këtë pozitë për te që me këtë lutje të arrijnë afërsinë e Allahut dhe forcimin e imanit.

Allahu, subhanehu ve teala, e ka caktuar këtë pozitë për Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, për shumë shkaqe, e njëra prej tyre është lutja e pasuesve të tij ndaj Allahut, subhanehu ve teala, që t'ia japë këtë pozitë për shkak të imanit që e kanë arritur me ndihmën e tij, pagja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi te!

KAPTINA E NËNTË

ALLAHU UA KA OFRUAR XHENETIN ROBËRVE TË TIJ

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ اشْتَرَى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنْفُسَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ بِأَنْ لَهُمُ الْحَيَاةَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَيَقْتُلُونَ وَيُقْتَلُونَ وَعَدَا عَلَيْهِ حَقًّا فِي التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ وَالْقُرْآنِ وَمَنْ أَوْفَى بِعَهْدِهِ مِنَ اللَّهِ فَاسْتَبِشِرُوا بِبَيْعِكُمُ الَّذِي بَايَعْتُمْ بِهِ وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ﴾

"Allahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me Xhenet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. (Allahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzoni tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh".³⁶

Allahu, subhanehu ve teala, Xhenetin e ka bërë kompenzim për shpirtat e besimtarëve dhe pasuritë e tyre, në kuptim se nëse i sakrifikojnë për Te, meritojnë kompenzim. Ai ka lidhur me ta këtë marrëveshje dhe e ka përforcuar me pjesëz për forcim, mandej në formë të kohës së kaluar e cila implikon mosndryshueshmëri dhe qëndrueshmëri.

Në *Xhamiu'n* e Tirmidhiut është shënuar transmetimi i Ebu Hurejres: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Ai që frikohet, në rrugë niset në mëngjes, e kush niset në rrugë herët, ai edhe do të arrijë (herët) në shtëpi. A nuk është malli i Allahut i shtrenjtë, a nuk është malli i Allahut - Xheneti?" Tirmidhiu thotë se hadithi është *hasengarib*.

³⁶ Et-Teube: 111.

Në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit është shënuar hadithi i Ebu Hurejres ku thuhet se një beduin (fshatar) ka ardhur te Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, dhe i ka thënë: "O i Dërguar i Allahut, më udhëzo në punën të cilën nëse e punoj do të më fusë në Xhenet". Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, tha: "Të jesh rob i Allahut dhe mos t'i përshkruash shok, ta falësh namazin, japësh zekatin dhe agjërosh Ramazanin". Beduini tha: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do t'i shtoj kësaj asgjë e as nuk do të pakësoj". Pasi që u kthye Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, tha: "Kush don të shohë bano-rin e Xhenetit, le të shikojë këtë njeri".

Në *Sahihun* e Muslimit nga Xhabiri, radijallahu anhu, është shënuar: "Nu'man ibën Kavali ka ardhur te Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe i ka thënë: 'O i Dërguar i Allahut, nëse i falë namazet e obliguara, e ndaloj atë që është e ndaluar, dhe e lejoj atë që është e lejuar, a do të hyjë në Xhenet?' Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, i ka thënë: Po".

Në *Sahihun* e Muslimit është shënuar nga Othman ibën Afani: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Kush vdes duke mos i shoqëruar Allahut asgjë, do të hyjë në Xhenet".

Në *Sunenin* e Ebu Davudit është shënuar nga Mu'adh ibën Xhebeli: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: Fjala e fundit e të cilit është 'LA ILAHE IL-LALLAH' (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), do të hyjë në Xhenet".

Në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit nga Ebu Dherri është shënuar: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Më erdhi Xhibrili dhe më përgëzoi: Kush vdes prej umentit tënd duke mos i shoqëruar Allahut asgjë, do të hyjë në Xhenet. I thashë: A edhe nëse ka bërë prostitucion (zina) dhe nëse ka vjedhur? Tha: Edhe nëse ka bërë prostitucion dhe nëse ka vjedhur!".

Në *Sahihun* e Muslimit transmetohet se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ia ka dhënë papuçet e tij Ebu Hurejres, radijallahu anhu, dhe i ka thënë: *"Ec me këto papuçe dhe cilin e takon pas këtij muri duke dëshmuar se nuk ka zot tjetër pos Allahut, duke besuar thellë në këtë, përgëzoje më Xhenet"*.

Këtu, po ashtu duhet tërhequr vërejtjen se në Xhenet njeriu hyn vetëm me mëshirën e Allahut, kurse hyrja në te nuk është e pamvarur nga punët e njeriut, por ato janë shkak për të hyrë në te. Prandaj Allahu i Lartësuar ka vërtetuar se hyrja në Xhenet do të jetë në bazë të punëve:

﴿...وَتُؤَدُّوْا أَنْ تَلْكُمُ الْجَنَّةُ أُورِثْتُمُوهَا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ﴾

"E atyre u drejtohet thirrje: Ky është Xheneti, iu dha juve për atë që vepruat".³⁷

Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka mohuar se hyrja në Xhenet do të jetë në bazë të punëve: *"Askush prej jush nuk do të hyjë në Xhenet në bazë të punëve të tij"*. Mirëpo, nuk ka kundëthënie mes ajetit të cekur dhe hadithit nga dy shkaqe:

1. Sufjani dhe disa tjerë thonë: "Disa dijetarë thonë se shpëtimi nga Xhehenemi arrihet me falje nga Allahu, subhanehu ve teala, hyrja në Xhenet arrihet duke u mbështetur në mëshirën e Tij, derisa arritja e shkallëve dhe pozitive të ndryshme varet nga puna (veprat e punuara). Në këtë udhëzon edhe transmetimi i Ebu Hurejres, radijallahu anhu, të cilin e ka shënuar Tirmidhiu, se banorët e Xhenetit kur do të hynë në te, do të vendosen në bazë të punëve të tyre".

2. Se pjesëza (ب) në hadith me të cilin mohohet hyrja në Xhenet në bazë të punëve (بعملة) në realitet është kompensuese, d.m.th., ku një element ballafaqohet me

tjetrin, derisa e njëjta pjesëz kur me te vërtetohet hyrja, është shkajkore, respektivisht, ajo implikon një subjekt vendimtar në bashkërenditje të dy komponenteve në kuptim që një komponentë e vetme nuk është në përgjithësi e mjaftueshme të arrijë atë tjetrën.



³⁷ El-A'raf: 43.

KAPITULLI I DHJETË

BESIMTARËT E KËRKOJNË XHENETIN EDHE XHENETI I
KËRKON ATA

Allahu i Lartësuar thotë se ata që janë të pajisur me mend thonë:

﴿ رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا
ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ﴾ رَبَّنَا وَآتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَى
رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿

*"Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti ynë, jepna atë që nëpërmjet të dërguarëve Tu, na e premtove dhe në Ditën e Kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!"*³⁸ Ky ajete don të thotë: Na dhuro hyrjen në Xhenet, të cilin na e ke premtuar nëpërmjet të dërguarve Tu.

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

﴿ قُلْ أَذَلِكْ غَيْرٌ أَمْ حِنَّةَ الْخُلْدِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ كَانَتْ لَهُمْ جَزَاءً وَمَصِيرًا
لَهُمْ فِيهَا مَا يَشَاؤُونَ خَالِدِينَ كَانَ عَلَى رَبِّكَ وَعْدًا مَسْئُورًا ﴾

*"Thuaj: 'A është më mirë ai (zjarri i Xhehenemit) apo Xheneti i përjetshëm, i cili u është premtuar si shpërblim dhe vend jetese për të devotshmit'. E aty, atë që e dëshirojnë do ta kenë përgjithmonë. Ky premtim i Zotit tënd ka qenë dashtë kërkuar"*³⁹

³⁸ Ali Imran: 193, 194.

³⁹ El-Furkan: 15, 16.

Xhenetin e kërkojnë për vete robërit e Allahut besimtarë dhe për ta e kërkojnë edhe melekët. Vetë Xheneti i kërkon prej Allahut banorët e tij, kurse banorët e tij e kërkojnë për vete, por edhe melekët e kërkojnë për ta. Edhe peygamberët e kërkojnë për vete si dhe pasuesit e tyre.

E gjithë kjo sugjeron absolutetin e pushtetit të Tij dhe pasqyron mëshirën, mirësinë dhe bujarinë e Tij, e gjithë kjo është shprehje e detyrueshme e emrave dhe attributeve të Tij, refleksion i pashmangur i veprimeve të tyre dhe shfaqjeve që ju takojnë atyre, dhe ndarja e tyre nga veprimi dhe ligshmëria e tyre nuk është e pranueshme.

Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibën Maxheja kanë shënuar nga Enesi: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Secili musliman kur prej Allahut e kërkon Xhenetin tri herë, Xheneti thotë: O Allah, fute në Xhenet, kurse për ate që kërkon mbrojtje nga Allahu prej Xhehenemit tri herë, Xhehenemi thotë: O Allah, mbroje prej Xhehenemit".

Ebu Ja'la el-Mevsili transmeton nga Ebu Hurejra: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Kur njeriu kërkon mbrojtje nga Xhehenemi shtatë herë, Xhehenemi thotë: O Zot, robi Yt kërkoi mbrojtje prej meje, prandaj mbroje, dhe kur njeriu e kërkon Xhenetin shtatë herë, Xheneti thotë: O Zot, po më kërkon robi Yt, prandaj vendose në Xhenet". Transmetuesit e këtij hadithi i plotësojnë kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

Hasan ibën Sufjani transmeton nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kërkoni shumë prej Allahut Xhenetin dhe kërkoni mbrojtje te Ai nga Xhehenemi, sepse ata janë dy ndërhyrës (mediatorë) ndërmjetësimi i të cilëve pranohet, kështu që kur njeriu e kërkon prej Allahut shumë Xhenetin, Xheneti thotë: O Zot, ky robi Yt po më kërkon, prandaj vendose në mua. Kurse Xhehenemi thotë: O Zot, ky robi Yt kërkon prej teje mbrojtje prej meje, prandaj mbroje".

Një grup njerëzish nga gjeneratat e para të muslimanëve nuk e kërkonin Xhenetin prej Allahut, subhanehu ve teala, por thonin: "Na mjafton të kërkojmë mbrojtje nga Xhehenemi". Në mesin e tyre ishte edhe Sileh ibën Eshimi i cili falej natën deri në muzgun e mëngjesit, e mandej i ngrinte duart dhe thonte: "O Allahu im, më mbroj prej Xhehenemit! A thua vallë ndokush sikur unë do të kishte guxim të të lutë për Xhenet". Mes tyre, po ashtu ishte edhe Ata' es-Sulemi. As ai nuk e kërkonte Xhenetin, ndër-sa Salih el-Meriji i tha: "Më ka transmetuar Ebani nga Enesi se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Allahu i Lartësuar tha: Shikoni në fletoren e robit Tim, dhe te cili shihni se ka kërkuar prej Meje Xhenetin, Unë do t'ia jap, e kush prej Meje ka kërkuar mbrojtje prej Xhehenemit, Unë do ta mbrojë". Ata'i ka thënë: "Më mjafton të kërkoj mbrojtje prej zjarrit". Këtë transmetim e ka shënuar Ebu Ne'imi.

Ebu Davudi në *Sunenin* e tij ka shënuar transmetimin nga Xhabiri mbi namazin e Mu'adhrit dhe zgjatjen e tij: "Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, e ka pyetur djalo-shin i cili i është ankuar: Çka bën ti kur falesh, o biri i vëllait tim? Ai tha: Këndoj Kapitullin e parë të Librit, pastaj e lus Allahun për Xhenet dhe kërkoj strehim tek Ai nga Xhehenemi. Unë nuk e di *dendene*-në⁴⁰ tënde, e as *dende*-në e Muadhrit! I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, tha: *Unë edhe Muadhi rreth kësaj lutemi*".

Pra, Xhenetin e kërkojnë banorët e ardhshëm të tij, kur-se Xheneti ata i tërheqë. I njëjti rast është edhe me Xhehenemin. I Dërguari i Allahut na ka urdhëruar që të mos e lëmë pa e përmendur Xhenetin dhe Xhehenemin dhe të mos i harrojmë.

⁴⁰ Dendene: kur dikush thotë disa fjalë, intonacioni i të cilave është i dëgjueshëm, por jo edhe i kuptueshëm; është pak më shumë se murmuritje (*Nihajeh*).

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

EMRAT E XHENETIT DHE KUPTIMET E TYRE

Xheneti i ka disa emra që tregojnë veçoritë e tij. Emrat e tij janë të veçantë në lidhje me esencën e tij, dhe në këtë rast paraqesin sinonime, kurse janë të ndryshme duke marrë parasysh veçoritë e tij.

Emri i parë - Xhenet

Ky është emër i përgjithshëm me të cilin emërtohet ky vend dhe begatitë e ndryshme të tij, ëndjet, dëfrimet, gëzimet dhe zbavitjet që ai i përmban. Në esencë, ky emër është derivacion në kuptim të shprehjes *sitër* (perde, vel, mbrojtje) dhe *tagtijeh* (fshehje). Prej këtu rrjedh edhe fjala *xhenin* (embrion) për shkak të fshehjes së tij në barkun e nënës, *xhan* (xhinë), sepse janë të fshehur prej shikimit, *mexhen* (mburojë), sepse ajo e fshehë fytyrën dhe *mexhun* (i çmendur), sepse mendja e tij është e mbuluar. Xhenet quhet edhe kopshti, sepse në te ka strehim nga drunjtë.

Emri i dytë – Daru's-selam

Allahu, subhanehu ve teala, e ka quajtur me këtë emër në fjalët e Tij:

﴿لَهُمْ دَارُ السَّلَامِ عِنْدَ رَبِّهِمْ ...﴾

"Për ta do të jetë Shtëpia e Paqës (Xheneti) me Zotin e tyre..."⁴¹ dhe "Allahu ju fton në Shtëpinë e Paqës..."⁴² Xheneti vërtet e meriton këtë emër, sepse ai është shpëtim nga çdo telashe, pikëllim dhe pakënaqësi. Ajo është shtëpia e Allahut, subhanehu ve teala, me çka edhe Vetë quhet Es-Selam dhe me çka i ka përshëndetur banorët e tij.

﴿ وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَى دَارِ السَّلَامِ... ﴾

"...e përshëndetja e tyre është: Selam!"⁴³

﴿ ...وَالْمَلَائِكَةُ يَدْخُلُونَ عَلَيْهِمْ مِنْ كُلِّ بَابٍ ﴿٦٦﴾ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ بِمَا صَبَرْتُمْ فَنِعْمَ عُقْبَى الدَّارِ ﴾

"...ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (u thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin..."⁴⁴

Zoti, qoftë i lartësuar, do t'i përshëndetë banorët e Xhenetit, sepse Ai thotë:

﴿ سَلَامٌ قَوْلًا مِنْ رَبِّ رَحِيمٍ ﴾

"Kanë 'Selam', thënie e Zotit Mëshirues!"⁴⁵ Në bisedat e banorëve të Xhenetit do të jetë selami, d.m.th., nuk do të ketë biseda të kota dhe biseda që të çojnë në devijim, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا إِلَّا سَلَامًا... ﴾

"Ata nuk do të dëgjojnë atje ndonjë Lagva (fjalë të kota, të ulta e të rreme), por veçse Selame..."⁴⁶

⁴¹ El-En'am: 127

⁴² Junus: 25.

⁴³ Junus: 10.

⁴⁴ Er-Ra'd: 23, 24.

⁴⁵ Ja Sin: 58.

⁴⁶ Merjem: 62.

Emri i tretë – Daru'l-huld

Është quajtur me këtë emër, sepse banorët e tij asnjëherë nuk do të zhvendosen prej aty, siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ إِنَّ هَذَا لَرِزْقُنَا مَا لَهُ مِنْ لَفَادٍ ﴾

"Ky është furnizimi Ynë, i cili nuk ka të mbaruar".⁴⁷

Ai po ashtu thotë:

﴿ ...أُكَلِّمَهَا دَائِمٌ وَظُلْمًا... ﴾

"...ushqimi në të dhe hija në të është e përhershme".⁴⁸

Nga kjo shihet se është gabim të flitet për kalueshmërinë e Xhenetit (se ka karakter kalimtar) ose kalueshmërinë e lëvizjeve të banorëve të tij.

Emri i katërt – Daru'l-mukameh

Allahu i Lartësuar i cekë fjalët e banorëve të Xhenetit:

﴿ الَّذِي أَحَلَّنَا دَارَ الْمُقَامَةِ مِنْ فَضْلِهِ لَا يَمَسُّنَا فِيهَا نُصَبٌ وَلَا يَمَسُّنَا فِيهَا لُغُوبٌ ﴾

"I cili nga mirësia e Tij na vendosi në vendin e përjetshëm, ku nuk do të na prekë ndonjë mundim fizik dhe ku nuk na prekë ndonjë molisje".⁴⁹ Mukatili thotë se kuptimi i këtij ajeti është: "Na ka vendosur në Shtëpinë e përjetësisë, ku (banorët e tij) do të qëndrojnë përgjithmonë, nuk do të vdesin, e as që do të shpërngulen ndonjëherë prej tij". Ez-Zexhaxhi thotë: "Fjala mukame është në kuptim të fjalës

⁴⁷ Sad: 54.

⁴⁸ Er-Ra'd: 35.

⁴⁹ Fatir: 35.

ikameh (të banuarit, banim). Thuhet në fjalim: "Ky është vendbaim i përhershëm i imi".

Emri i pestë – Xhenetu'l-me'va

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ﴾

"Që pranë saj është Xhenetu'l Me'va (kopsht strehimi i...)"⁵⁰

Fjala el-me'va vjen në formë mefalun nga folja eva, je'vi në kuptim të hyrjet në vend, të shkuarit deri te ai dhe të vendosurit në te. Ata'i thotë: "Xhenetu'l-me'va është Xheneti ku gjejnë strehim Xhibrili dhe melekët". Mukatili dhe El-Kelbi thonë: "Ai është Xheneti ku tubohen shpirtat e shehidëve". Aishja, radijallahu anha, thotë: "Kjo është një prej bahçeve të Xhenetit".

Emri i gjashtë – Xhenetu 'adn

Disa thonë se ky është emër i një bahçeje prej bahçeve të Xhenetit. Por mendimi i drejtë është se me këtë nënkuptohen të gjitha xhenetet, kështu që të gjithë ata janë Xhenetu 'adn.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿جَنَّاتٍ عَدْنٍ الَّتِي وَعَدَ الرَّحْمَنُ عِبَادَهُ بِالْغَيْبِ إِنَّهُ كَانَ وَعْدُهُ مَأْتِيًا﴾

"Ato janë Xhenetet e Adnit, që Mëshiruesi u pat premtuar robërve të Vet, pa i parë ata (i besuan pa i parë), e premtimi i Tij është i kryer"⁵¹

Ai po ashtu thotë:

﴿جَنَّاتٍ عَدْنٍ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ﴾

"...dhe në banesat e këndshme në Kopshtet e Adnit"⁵²

Prejardhja e këtij emri udhëzon në ate se ai ka të bëjë me të gjitha xhenetet (kopshtet e Xhenetit), sepse më këtë nënkuptohet të banuarit dhe mbetja në te. Kur ndokush vendoset në ndonjë vend të caktuar, për te thuhet: 'adene bi'l-mekani, kurse 'adentu'l-belede don të thotë: jam vendosur në qytet. Xhevheriu thotë se Xhenatu 'adn d.m.th., Xhenetu ikameh (vendbanime në Xhenet). 'Adin është deve që qëndron (banon) në kullosë.

Emri i shtatë - Daru'l-hajevan

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا نَهْوٌ وَلَعِبٌ وَإِنَّ الدَّارَ الْآخِرَةَ لَهِيَ الْحَيَوَانُ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ﴾

"Vërtet që banesa e Jetës së Pastajme, - ajo është jeta e vërtetë (e përjetshme, e pasosur)..."⁵³

Dijetarët thonë se Ahireti, respektivisht Xheneti është vend i jetës së vërtetë ku nuk do të ketë vdekje. Kelbi thotë: "Xheneti nënkupton jetesë pa vdekje". Ebu 'Ubejde thotë: "Fjala hajjah ka kuptim të njëjtë sikurse edhe fjala hajevan (jetë). Kurse ajeti i cekur mund të ketë dy kuptime:

1. Se jeta në botën e ardhshme është jetë e vërtetë, sepse atje nuk ka dëshpërim dhe skamje.
2. Se ai është vend ku nuk ka kalueshmëri dhe zhdukje siç është zhdukja e qenieve të gjalla në këtë botë, kështu që ai më shumë e meriton këtë emër se sa jeta e cila kalon dhe shuhet me vdekje.

⁵⁰ En-Nexhm: 15.

⁵¹ Merjem: 61.

⁵² Es-Saff: 12.

⁵³ El-'Ankebut: 64.

Emri i tetë - El-Firdeus

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ ﴿٥٤﴾ الَّذِينَ يَرِثُونَ الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٥٥﴾﴾

"Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdeusin dhe aty ata janë përgjithmonë".⁵⁴

Me emrin Firdeus quhet i tërë Xheneti, por edhe pjesa më e vlefshme dhe më e lartë e tij, dhe sikur që ky e meriton këtë emër para pjesëve tjera të Xhenetit. Firdeus në esencë don të thotë *bahçe me hardhi të verës*. Ed-Dahakiu thotë: "Kjo është bahçe e rrethuar me drunj".

Emri i nëntë – Xhenetu'n-ne'im

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ النَّعِيمِ ﴿٥٦﴾﴾

"Vërtet se ata që besojnë dhe që punojnë mirësi e drejtësi, mu për këta janë Kopshtet e Kënaqësisë së Xhenetit".⁵⁵

Ky emër, po ashtu ka të bëjë me tërë Xhenetin, për shkak të llojlojshmërisë së ushqimeve, pijeve, robeve, pamjeve, erërave të mira dhe shfaqjeve të mrekullueshme, si dhe llojeve tjera të kënaqësive të jashtme dhe brendshme që ai i përmban, në të cilat do të kënaqen banorët e tij.

⁵⁴ El-Mu'minun: 10, 11.⁵⁵ Lukman: 8.

Emri i dhjetë – El-mekamu'l-emin

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي مَقَامٍ أَمِينٍ ﴿٥٦﴾﴾

"Sigurisht se mutekunët (të përkushtuarit në Besim të Pastër Islam) do të jenë në vendin e Sigurisë (Xhenet)".⁵⁶

Mekam është vend i qëndrimit. Kurse *emin* d.m.th. i sigurtë nga çdo e keqe, fatkeqësi dhe pakënaqësi. Ai që ka frikë Allahun është i sigurtë nga zhdukja dhe shkatërrimi dhe banorët e Xhenetit janë të sigurtë nga dalja prej Xhenetit (nuk do të dalin), hidhërimi dhe fatkeqësia.

Emri i njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë – Mak'adu's-sidk ve kademu's-sidk

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَنَهْرٍ ﴿٥٧﴾ فِي مَقْعَدٍ صِدْقٍ عِنْدَ مَلِكٍ مُّقْتَدِرٍ ﴿٥٨﴾﴾

"Me të vërtetë që mutekinët (të përkushtuarit në Besim të Pastër Islam) do të jenë ndër Kopshte të Begatë dhe Lumenj (të Xhenetit). Në kuvendin e së Vërtetës..."⁵⁷

Allahu, subhanehu ve teala, e ka quajtur Xhenetin vend i së vërtetës, sepse aty arrihet e gjithë ajo me të cilën nënkuptohet pozitë e mirë. Për dashurinë e sinqertë thuhet *mevadeh sidkäh*, nëse është e plotë dhe e fortë siç thuhet për ëmbëlsinë e vërtetë *halaveh sadikäh*. Nga këtu për fjali-

⁵⁶ Ed-Duhan: 51.⁵⁷ El-Kamer: 54, 55.

min e vërtetë thuhet *el-kelamu's-sidku*, sepse me te tregohet mendimi (kuptimi) i vërtetë.

Disa dijetarë nocionin *sidk* (në ajetin e sipërpërmendur, vër. e përkth.) e komentojnë si Xhenet. Të dytët me këtë term nënkuptojnë të gjitha ato punë me të cilat arrihet Xheneti. Të tretët mendojnë se me këtë term ka për qëllim Xhenetin që u është premtuar më parë nga Allahu. Të katërtët thonë se këtu ka për qëllim Pejgamberin, sepse ata, gjithë këtë e kanë arritur pikërisht duke iu falënderuar udhëzimit të cilin ai ua ka përcjellur.



KAPITULLI I DYMBËDHJETË

TË PARËT QË DO TË HYNË NË XHENET

I pari që do të troket në dyert e Xhenetit

Tirmidhiu ka shënuar se Ibën Abasi ka thënë: "Një grupë e sahabëve ishin ulur duke e pritur Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, doli dhe derisa po u afrohej pa se ishin duke diskutuar dhe e dëgjoi bisedën e tyre. Njëri prej tyre tha: 'Për çudi, Allahu prej krijesave të Tij Ibrahimin e ka marrë për mik'. Tjetri tha: 'Kjo nuk është çudi më e madhe se bashkëbiseduesi i Tij, Musai. Allahu sigurisht ka biseduar me te'. Dikush prap tha: 'Por, Isai është fjala e Allahut dhe ruhi i Tij'. Tjetri tha: 'Kurse Ademin Allahu e ka dalluar'. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, doli para tyre, u dha selam dhe tha: *E dëgjova bisedën tuaj - Ibrahimin vërtetë është mik i Allahut dhe kjo është kështu, Musai është bashkëbisedues i Tij edhe kjo është kështu, Isai është ruh nga Allahu dhe kjo është kështu, kurse Ademin e ka dalluar dhe kjo është kështu, por unë, pa u lavdëruar, jam i dashuri i Allahut, unë do të jem, pa u lavdëruar, mbrojtësi i parë dhe i pari që do t'i pranohet ndërmjetësimi në Ditën e Gjykimit; unë, pa u lavdëruar, do ta mbaj flamurin e falënderimit ndaj Allahut në Ditën e Gjykimit; unë, pa u lavdëruar, jam i pari që do ta lëviz hallkën e Xhenetit, e ajo do të më hapet dhe unë do të hyjë në te, e me mua besimtarët e varfër⁵⁸; dhe unë jam, pa u lavdëruar, njeriu më i ndershëm, prej njeriut të parë e deri te i fundit".*

⁵⁸ Nuk ka për qëllim ata që janë nevojtarë në aspekt të pasurisë, por ka për qëllim të gjithë ata që janë të varur nga Allahu në pikëpamje të

Tirmidhiu ka shënuar nga Enesi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Unë jam njeriu i parë që do të del kur njerëzit do të ringjallen, unë do të flas për ta kur ata do të heshtin, dhe udhëheqësi i tyre kur të arrijnë, edhe mbrojtës i tyre kur ata do të mbahen në pyetje, edhe ai që do t'i përgëzojë kur ata të bien në dëshpërim; bajraku i falënderimit do të jetë në duart e mia, dhe unë, atë ditë, pa u lavdëruar, do të jem pasardhësi më i ndershëm i Ademit te Zoti im".*

Populli i parë që do të hynë në Xhenet

Në përmbledhjet e Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Ne jemi të fundit (si umet), por në Ditën e Gjykimit do të jemi të parët, dhe ne do të jemi të parët që do të hyjnë në Xhenet, edhe pse secili popull ka pranuar shpalljen para nesh, e ne e kemi pranuar pas tyre. Pastaj, kjo është dita rreth së cilës ata janë përcarë. Hebrenjtë (e festojnë) ditën e nesërme (të shtunën), të krishterët të pasnesërmen (të dielën)".*

Pasuesit e parë të Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, që do të hyjnë në Xhenet

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Grupi i parë që do të hynë në Xhenet i kanë pamjet e tyre sikurse hëna e plotë".*

Në Musnedin e Ahmed ibën Hanbelit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu

fjalëve të tyre, punëve, pasurisë etj., pra, kanë bindje se për gjithë atë që e kanë nga kjo duhet falënderuar vetëm mirësinë e Allahut.

alejhi ve selem, ka thënë: *"Më janë paraqitur tre personat e parë që do të hyjnë në Xhenet dhe tre personat e parë që do të hyjnë në Xhehenem. Tre të parët që do të hyjnë në Xhenet janë: shehidi, robi të cilin robëria në këtë botë nuk e ka penguar që t'i nënshtrohet Allahut dhe i varfëri i ndershëm që ka shumë fëmijë. Tre të parët që do të hyjnë në Xhehenem janë: sunduesi i fugishëm, i pasuri i cili nuk ndanë nga pasuria e tij atë që Allahu e ka caktuar dhe i varfëri mendjemadh".*

Të varfërit do të hyjnë në Xhenet para të pasurve

Në Sahihun e Muslimit nga Abdullah ibën Omeri, radijallahu anhu, është shënuar: *"E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: 'Muhaxhirët e varfër do të hyjnë në Xhenet katërdhjet vjetë para të pasurve'".*

Në Musnedin e Ahmed ibën Hanbelit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Muslimanët e varfër do të hyjnë në Xhenet gjysme dite para të pasurve (sipas vlerësimit të kësaj bote)".* Tirmidhiu këtë hadith e ka vlerësuar si hasen-sahih.

Në të njëjtën përmbledhje të haditheve është shënuar nga Ibën Abasi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Do të takohen dy besimtarë në dyert e Xhenetit: besimtari i cili ka qenë i pasur dhe besimtari i cili ka qenë i varfër në këtë botë, dhe i varfëri do të hyjë në Xhenet, kurse i pasuri do të mbahet aq sa Allahu të dëshirojë. Pastaj edhe ai do të hyjë në Xhenet, dhe do ta takojë i varfëri e do t'i thotë: O vëllai im, pse u ndale? Ai do të përgjigjet: Vëllai im, para se të vijë te ti aq djersë kanë dalë prej meje sa që kanë mundur ta shuajnë etjen një mijë deve që kanë ngrënë bimë të njelmta".*

Nuk është patjetër që personi i cili ka hyrë në Xhenet më parë se të tjerët të jetë në pozitë më të lartë se ata që kanë hyrë pas tij, por mund të ndodhë që ai që hyn më

vonë të jetë në pozitë më të lartë se ai që ka hyrë para tij. Argument për këtë është se në umetin e Muhamedit, sala-llahu alejhi ve selem, ka shtatëdhjetë mijë njerëz që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, derisa disa të tjerë që do të japin llogari, do të kenë nderime më të mëdha se shumica e atyre që kanë hyrë pa dhënë llogari.

Pra, ka dy lloj privilegje: të hyhet në Xhenet më parë ose të kihet pozitë më të lartë në të. Besimtari mund t'i ketë dy privilegjet ose njëren prej tyre. Disa prej tyre do t'i kenë edhe njëren edhe tjetrën, e disa do të kenë privilegj që të hyjnë më parë në Xhenet.



KAPITULLI I TREMBËDHJETË

ATYRE QË U ËSHTË GARANTUAR XHENETI

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَحِثَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٥٩﴾ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَاظِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿٦٠﴾ وَالَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا فَاحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاَسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ وَمَن يَغْفِرِ اللَّهُ فَاَسْتَغْفِرُوا لَهُمْ وَمَن يَصِرُوا عَلَىٰ مَا فَعَلُوا وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾ أُولَٰئِكَ جَزَاءُهُمْ مَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ وَحِثَّاتٌ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَنِعْمَ أَجْرُ الْعَامِلِينَ ﴿٦٢﴾

*“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë shilirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit. Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe Xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj, e aty do të rrinë përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë”.*⁵⁹

Në ajet janë përmendur grupet e të devotshmëve për të cilët është përgatitur Xheneti. Është cekur se ata

⁵⁹ Ali Imran: 133-136.

shpenzojnë në kohë begatie e fatkeqësie, se përmbahen nga të bërit keq njerëzve, e frenojnë mllëfin dhe falin, se pendohen te Allahu dhe nuk vazhdojnë në mëkate. Ata sillen kështu ndaj Zotit të tyre dhe krijesave të Tij.

Në *Sahihun* e Muslimit është shënuar nga Ijad ibën Himari se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka mbajtur hutbe, dhe mes tjerash ka thënë: *“Tre persona do të jenë banorë të Xhenetit: sunduesi i drejtë, bujar dhe në rrugë të drejtë, njeriu i mëshurshëm ndaj farefisit dhe muslimanëve, dhe njeriu i ndershëm që ka shumë fëmijë”*.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Harith ibën Vehbi: *“E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: A doni t’ju tregoj se kush do të jetë banor i Xheneti?! Ky do të jetë secili i pafuqishëm të cilin edhe të tjerët e kanë konsideruar të pafuqishëm, por sikur ky të kërkonte prej Allahut, Ai do t’i përgjigjej atij! A doni t’ju tregoj se kush do të jetë banor i Xhehenemit?! Ai do të jetë çdo mendjemadh, i pasjellshëm dhe harbut!”*.

Ibën Maxheja ka shënuar nga Ibën Abasi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *“Banorët e Xhenetit do të jenë ata, veshët e të cilëve në prezencë të tyre janë mbushur me lavdërata të njerëzve, kurse banorë të Xhehenemit do të jenë ata veshët e të cilëve në prezencë të tyre janë mbushur me sharje (fyerje) të njerëzve”*.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Enesi, radijallahu anhu: *“Disa njerëz bartnin një xhenaze dhe folën mirë për të. Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ve selem, tha: “Ashtu duhet të jetë!”*. Pastaj sollën një xhenaze tjetër dhe njerëzit folën keq për të. Pejgamberi salallahu alejhi ve selem, tha: *“Ashtu duhet të jetë!”*. Atëherë Umer ibnul Hatabi, radijallahu anhu, pyeti: *“Çka duhet të jetë ashtu?”*. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u përgjigj: *“Për të parin folët mirë dhe duhet të shkojë në Xhenet. Ndërsa, për të dytin folët keq dhe duhet të shkojë në Xhehenem. Ju jeni dëshmitarë të Allahut në tokë”*.

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

NË XHENET DO TË KETË MË TEPËR GRA SE BURRA, POR PO ASHTU EDHE NË XHEHENEM

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *“Grupi i parë i cili do të hyjë në Xhenet do të jetë në figurë të hënës katërmëdhjetëshe, e ata më pas në figurë të yllit më të shndritshëm, i cili në qiell shndritë më së shumti. Për çdo njeri do të ketë nga dy gra, palca e kërcikës së të cilave do të shihet nga jashtë prej bukurisë”*.

Në Xhenet nuk do të ketë të pamartuar, e nëse përmen-den gratë e dynjasë në këtë rast gra në këtë botë duhet të ketë më shumë se burra, dhe nëse mes tyre janë edhe hyritë e Xhenetit - atëherë në dynja nuk është patjetër që gra të ketë më shumë se burra. Është evidente se për këtë numër të madh të grave duhet falënderuar hyritë e Xhenetit në pajtim me transmetimin e Ebu Hurejres të cilin e ka shënuar Ahmed i në *Musnedin* e tij, me fjalë tjera, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *“Në Xhenet burri do t’i ketë dy gra nga hyritë e Xhenetit. Secila prej tyre do të jetë e veshur me shtatëdhjetë rrobe (petka) dhe çdonjëri prej tyre nëpër rrobe do t’i shihet brendia e këmbës së saj”*.

Buhariu dhe Muslimi kanë shënuar hadithin nga Xhabiri, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u ka thënë disa grave: *“Ju do të jeni pak në Xhenet”*. Një grua e pyeti: *“Pse o i Dërguar i Allahut?”*. Ai u përgjigj: *“Shumë mallkoni dhe nuk jeni falënderuese ndaj burrave tuaj”*.

Shkaku se në Xhehenem do të ketë më shumë gra është cekur në transmetimin autentik të Ibën Omerit, radijallahu anhu, ku Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, u ka thënë disa grave: *“O ju gra! Jepni sadaka dhe bëni istigfar (kërkoni falje) shumë, sepse unë kam parë se ju e përbëni shumicën e banorëve të Xhehenemit!”*. Një grua e pyeti: *“O i Dërguar i Allahut, pse ne jemi shumica e banorëve të Xhehenemit?”*. *“Shumë mallkoni - tha i Dërguari i Allahut - dhe jeni jofalënderuese ndaj burrave tuaj. Nuk kam parë më të mangëta në mendje dhe në fe se sa gratë, të cilat arrijnë t’ia marrin mendjen edhe burrit më të vendosur”*. Dikush e pyeti: *“O i Dërguari i Allahut, ku qëndron mangësia e mendjes së tyre?”*. Ai u përgjigj: *“A nuk është dëshmia e dy grave sa dëshmia e një burri?”*. Ai e pyeti përsëri: *“O i Dërguari i Allahut, ku qëndron mangësia e fesë së tyre?”*. Ai ia ktheu: *“A nuk është e vërtetë se kur janë me menstruacione, nuk falen dhe nuk agjërojnë?”*.



KAPITULLI I PESËMBËDHJETË

ATA QË DO TË HYNË NË XHENET PA DHËNË LLOGARI

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu: *“E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: Do të hyjnë në Xhenet një grup nga umeti im, ata do të jenë shtatëdhjetë mijë dhe fytyrat e tyre janë si hëna e plotë. U ngrit Ukashe ibën Muhsini dhe tha: ‘O i Dërguar i Allahut, lute Zotin që mua të më bën njërin prej tyre’. Pejgamberi tha: ‘O Allah, bëre njërin prej tyre’. U ngrit edhe një sahab dhe tha: ‘O i Dërguar i Allahut, lute Allahun që të më bën njërin prej tyre’. Pejgamberi tha: Të parapriu Ukasheja”*.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit, e ne do ta marrim versionin që e ka shënuar Muslimi, qëndron se Hadif ibën Abdurrahmani ka thënë: *“Isha te Se’id ibën Xhubejri, dhe ai pyeti: ‘Kush prej jush e ka parë atë yllin që ra mbrëmë?’*. *‘Unë e kam parë! - thashë unë, - mirëpo, nuk isha në kurrfarë namazi, më kafshoi një gjarpër helmues!’*. *‘Çfarë bëre?’ - më pyeti ai e unë i thashë: Kërkova të më bëhet rukje. ‘E ç’ të shtyri të bësh kësh-tu?’ - më pyeti ai e unë i thashë: ‘Një hadith që na ka treguar Sha’biu, duke u thirrur në Burejden, ku thuhet: ‘Rukja lejohet vetëm kur njeriu është i magjepsur ose e ka kafshuar ndonjë kafshë helmuese!’*. *Mirë ka bërë ai që vepruar sipas asaj që ka dëgjuar’ - ka thënë ai. ‘Mirëpo, neve Ibën Abasi na ka transmetuar këtë thënie të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem: Mu paraqitën mua popujt, filloi të kalon një profet dhe me te umeti i tij, një profet tjetër dhe me te disa persona, një tjetër dhe me te dhjetë veta, një*

tjetër dhe me te pesë veta dhe një profet tjetër i vetmuar! Unë shikova dhe pashë një nxirje (grup njerëzish) të madhe e thashë: 'O Xhibril, a janë ata umeti im?'. Tha: 'Jo, por shiko lartë'. Unë shikova lartë dhe atje pashë një nxirje (grup njerëzish) shumë të madhe. Më tha: 'Ky është umeti yt!'. Mes tyre kishte shtatëdhjetë mijë prej atyre që do të hynë në Xhenet pa dhënë llogari dhe pa kurrfarë vuajtje!'. Mandej u ngrit dhe hyri në shtëpinë e tij, kurse njerëzit filluan të flasin se kush do të jenë ata që do të hynë në Xhenet pa dhënë llogari dhe vuajtur aspak. Të parët thanë: "Këta mund të jenë ata që janë shoqëruar me Pejgamberin e Allahut, salallahu alejhi ve selem!". Tjerët thanë: 'Këta mund të jenë ata që janë lindur në Islam dhe Allahut nuk i kanë shoqëruar asgjë në Hyjninë e Tij', duke cekur edhe disa gjëra tjera. Në këtë moment hyri i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, dhe i pyeti: "Për çka jeni duke diskutuar?" - dhe kur i treguan, ai u tha: "ata që nuk kanë kërkuar prej tjerëve t'u bëhet rukje, nuk janë marrë me ogure, nuk janë shëruar me të djegur dhe vetëm në Zotin e tyre janë mbështetur."

Te Buhariu është shënuar "ata që nuk kanë bërë rukje".

Mësuesi ynë - i cili është edhe mendimi i drejtë - thotë: "Shprehja ata që nuk kanë bërë rukje është e qartë se është gabim i ndonjë transmetuesi të hadihtit. Domethënë, Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, personat që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari i ka përshkruar si ata të cilët në mënyrë praktike e kanë praktikuar këtë parim të njëshmërisë së Allahut, të cilët këtë parim me asgjë nuk e kanë rrezikuar, që do të thotë se nuk kanë kërkuar nga të tjerët t'u bëjnë rukje, nuk kanë parashikuar fatin me fluturimin e shpendëve dhe janë mbështetur vetëm në Allahun. Oguret, me fjalë tjera, është një lloj politeizmi; refuzimi i çdo lloji të ogureve dhe kërkimi prej të tjerëve të bëjnë rukje është një lloj i plotësimit të mbështetjes në Allahun!".

Aishja, radijallahu anhu, i ka bërë rukje Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, por rukje i ka bërë edhe

Xhibrili. Mirëpo, ai vetë nuk ka kërkuar t'i bëhet rukje. Po ashtu, në hadithin e lëndës (për ata shtatëdhjetë mijë) nuk ka thënë: dhe atyre askush nuk u ka bërë rukje, por ka thënë se ata prej askujt nuk kanë kërkuar t'u bëhet rukje.

Në Sahihun e Muslimit është shënuar nga Imran ibën Husejni, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Shtatëdhjetë mijë njerëz nga umeti im do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari dhe pa kurrfarë vuajtje!". Kur është pyetur se kush do të jenë ata njerëz, ka thënë: Ata që nuk bëjnë kauterizim⁶⁰, që nuk kërkojnë t'u bëhet rukje dhe ata që nuk mirren me ogure, por mbështeten në Zotin e tyre!".

Grushti i Zotit të Lartësuar

Taberaniu ka shënuar nga Utbe es-Sulemiu, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Zoti im i Lartësuar ka premtuar se prej umetit tim pa dhënë llogari në Xhenet do t'i fusë shtatëdhjetë mijë dhe se çdo një mijëve prej tyre do t'ua mundësojë që të ndërmjetësojnë për shtatëdhjetë mijë të tjerë. Mandej Zoti im i Lartësuar me shuplakat e Tij do t'i kapë tre grushta". Omeri shqiptoi tekbiere dhe tha: "Ata shtatëdhjetë (mijë) të parët do të ndërmjetësojnë për të parët e tyre, pasardhësit dhe farefisin, e unë lutem që të jam në njërën prej atyre grushtave!".

El-Hafidh ibën Abdulvahidi thotë: "Nuk më është e njohur se në zinxhirin e këtij transmetimi ka ndonjë mangësi!".

⁶⁰ Djegie të plagës me mjete kimike, përmes hekurit të skuqur në zjarr, etj., për ta penguar procesin e mëtejshëm.

KAPITULLI I GJASHTËMBËDHJETË

CILËSITË E XHENETIT

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Enes ibën Maliku: "Ebu Dherri rrëfen se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *Hyra në Xhenet ku pash kube me gurë të çmueshëm, kurse toka ishte nga misku*".

Në *Musned* është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu: "Thamë: 'O i Dërguar i Allahut, na trego për Xhenetin! Nga çka është i ndërtuar?'. Ai tha: "Tullat janë nga ari dhe argjendi, balta e tij është misk, pragjet e tij janë nga margaritari dhe diamanti, kurse toka nga shafrani. Ai që hyn në te do të kënaqet dhe nuk do të ketë vështirësi, aty do të mbetet përgjithmonë dhe nuk do të vdesë".

Muslimi ka shënuar nga Ebu Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, e ka pyetur Ibën Sajadin për tokën e Xhenetit, e ai ka thënë: "(Ajo është) Pluhur, i bardhë, nga misku i pastër". Pejgamberi i Allahut tha: "Të vërtetën e ka thënë". Transmetim të ngjashëm ka shënuar Ibën Ebu Shu'be nga Ebu Nadreti.

Ibën Ebu'd-Dunja ka shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Toka e Xhenetit është e bardhë, kullosa nga kamfuri dhe nga kjo përhapet aroma e miskut siç përhapen rëra në shkretëtirë, aty ka lumej që rrjedhin pa ndarë, aty tubohen banorët e Xhenetit, prej shkallëve të larta dhe të ulta për t'u njohtuar, e Allahu dërgon një frymë (erë) mëshire dhe e përhapë mbi ta frymën (erën) e miskut, pastaj njeriu (banori i Xhenetit) i kthehet gruas së tij më i bukur dhe më besnik".

Drita e Xhenetit dhe bardhësia e tij

Buhariu ka shënuar nga Ibën Abasi, radijallahu anhu, se një njeri e ka pyetur se çfarë është toka e Xhenetit e ky i është përgjigjur: "Mermer i bardhë nga argjendi, sikur pasqyrë". E pyeta: "Çfarë është drita e tij?". Tha: "Është e tillë siç e shef para se të del dielli, e tillë është drita e tij, me ate që në Xhenet nuk ka as diell as ftohtësi!".

Në *Sunen ibën Maxhe* ka shënuar nga Usame ibën Zejdi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "A e doni Xhenetin? Asgjë nuk mund të krahasohet me te! Pasha Zotin e Qabes, ai është i tëri dritë që vezullon, në te ka aromë të këndshme (nga më e mira), pallate të ngritura, lumej që nuk shteren, fryte të pjekura, gra të bukura, shumë rrobe, vendbanim i përherëshëm në vend plotësisht të sigurtë, fryte dhe perime, gëzime dhe begati, në vend të ngritur dhe shkëlqyer'. Sahabët thanë: "Po, o i Dërguar i Allahut, ne e dojmë Xhenetin". Pejgamberi tha: "Thoni: "Nëse don Allahu". Ata thanë: "Nëse don Allahu!".

Pallatet e Xhenetit

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ لِكِنَّ الدِّينِ اتَّقُوا رَبَّهُمْ لَهُمْ غُرَفٌ مِّنْ فَوْقِهَا غُرَفٌ مَّبْنِيَةٌ... ﴾

"Ndërkaq, ata që u ruajtën për hir të Zotit të tyre, për ta do të ketë dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën...".⁶¹

Allahu, subhanehu ve teala, kështu na ka lajmëruar se në Xhenet dhomat janë njëra mbi tjetrën dhe se ato janë krijuar, se nuk janë vetëm metaforë.

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

⁶¹ Ez-Zumer: 20.

﴿أَوَلَيْكَ يُحْزُونَ الْعُرْفَةَ بِمَا...﴾

"Për shkak se duruan, të tillët shpërblehen me një shkallë të lartë (Xhenet)...".⁶² Në një ajet jtetër thotë:

﴿يَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَيُدْخِلْكُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ وَمَسَاكِينٍ طَيِّبَةٍ فِي جَنَّاتٍ عَدْنٍ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ﴾

"Ai (Allahu) ua falë mëkatet tuaja, ju shpie në Xhenete nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe në pallate të bukura në Xhenetet e amshueshme, e këto janë ai sukcesi më i madh".⁶³

Tirmidhiu ka shënuar nga Aliu, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Në Xhenet ka dhoma që u duket pamja e jashtme nga brendësia e tyre dhe brendësia e tyre nga jashtë". Një beduin u ngrit dhe pyeti: "Për kë do të jenë ato, o i Dërguar i Allahut?". Ai u përgjigj: "Do të jenë për ata që shpërndajnë ushqim, thonë fjalë të mira, janë të përqendruar në agjërim dhe falen natën derisa të tjerët flejnë".

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Musa, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Vërtet një besimtar në Xhenet do të ketë një ombrellë nga një e vetmja kokërr e diamantit, i cili do të jetë me vrimë aq sa vrima e tij në lartësi do të jetë e gjatë gjashtëdhjetë milje. Besimtari aty do ta ketë familjen e tij të cilës do t'i shkojë dhe vijë. Familjet e tij nuk do të shihen ndërmjet veti".

Në veprat e haditheve të cekura më parë është shënuar nga Enesi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kam hyrë në Xhenet dhe e pashë një pallat nga ari dhe thashë: 'Për kë është ky pallat?'. 'Për një njeri

⁶² El-Furkan: 75.

⁶³ Es-Saff: 12.

nga fisi kurejsh' - m'u përgjigjën, e mendova se unë jam andaj pyeta: 'Kush është ai?'. 'Omer ibën Hatabi' - m'u përgjigjën". Këtë Hadith e transmeton edhe Xhabiri, dhe është shënuar në të njëjtat përmbledhje të haditheve.

Aroma e Xhenetit

Tirmidhiu ka shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ai që vret një njeri prej atyre që u është dhënë siguria në shtetin islam, në mesin e jobesimtarëve, nuk do të ndjejë aromën e Xhenetit, kurse aroma e tij arrin sa udhëtimi shtatëdhjetë vjet". Transmetuesit e këtij hadithi i plotësojnë kushtet që hadithi të konsiderohet autentik.

Ka dy lloje të aromave të Xhenetit: aroma që është prezente edhe në këtë botë që ndonjëherë e marrin erë shpirtat, por njerëzit nuk mund ta njohin dhe aroma që mund të dallohet me shqisat e nuhatjes, siç mund të ndjehet aroma e luleve. Për banorët e Xhenetit është e përbashkët se do të mund të dallojnë aromën e Xhenetit si nga afër ashtu edhe nga larg, në botën tjetër. Ndërkaq në këtë botë, mund ta ndjejnë sipas dëshirës së Allahut, vetëm disa pejgamberë.



KAPITULLI I SHTATËMBËDHJETË

BANORËT E XHENETIT

Ata do t'i dinë vendbanimet e tyre në Xhenet

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...وَالَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَلَنْ يُضِلَّ أَعْمَالَهُمْ ﴿٦٤﴾ سَيُجْزِيهِمْ وَيُصَلِّحُ
بِأَنَّهُمْ ﴿٦٥﴾ وَيُدْخِلُهُمُ الْجَنَّةَ عَرَّفَهَا لَهُمْ﴾

"E ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, atyre kursesi nuk ua humb veprat (por ua shton). Ata do t'i udhëzojë dhe do të përmirësojë gjendjen e tyre. Dhe do t'i shtie në Xhenetin, të cilin ua ka bërë të njohur atyre".⁶⁴

Muxhahidi thotë se ky ajet ka këtë kuptim: "Do t'i udhëzojë banorët e Xhenetit për në shtëpitë dhe vendbanimet e tyre, kështu që ata nuk do të gabojnë, sikur t'i kishin banuar prej kur janë krijuar". Ibën Abasi thotë: "Ata vendbanimet e tyre i dinë më mirë se njerëzit që, pasi që e kanë falur namazin e xhumasë, nisen për në shtëpitë e tyre".

Mukatil ibën Hajani thotë: "Na është bërë e ditur se meleku i cili është i obliguar që ta ruajë njeriun do të ecë nëpër Xhenet. Njeriu do ta përcjell derisa nuk arrin te vendbanimi që është bërë nijet për te, dhe ai do t'ia tregon gjithë ate që Allahu ia ka dhënë në Xhenet, dhe kur të hyjë në vendbanim, ai dhe gratë e tij, meleku do të largohet prej tij".

⁶⁴ Muhamed: 4-6.

Disa thonë se folja ('arrefe, njoh), në ajetin e cekur vjen nga fjala ('urf) që don të thotë i mirë, i bukur, i këndshëm, dhe në këtë rast folja e cekur ka kuptim *ua ka bërë Xhenetin e bukur dhe të këndshëm*. Buhariu ka shënuar nga Ebu Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, secili prej tyre (banorët e Xhenetit) do ta njohë vendbanimin e tij në Xhenet prej asaj që e ka pasur në këtë botë".

Veçoritë e banorëve të Xhenetit dhe moshja e tyre

Në Musnedin e Ahmed ibën Hanbelit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Allahu e krijoi Ademin dhe gjatësia e tij ka qenë gjashtëdhjetë arshin dhe pastaj i tha: 'Shko dhe jepu selam atyre melekëve, dhe dëgjo se si do të përshëndetin. Përshëndetja e tyre do të jetë përshëndetja yte dhe e pasardhësve tu!'. Ai u tha: 'Es-selamu alejkum', kurse ato u përgjigjën: 'Es-selamu alejke ve rahmetullah', dhe ashtu shtuan ve rahmetullah. Secili që do të hyjë në Xhenet, do të hyjë në pamjen e Ademit, gjatësia e tij do të jetë gjashtëdhjetë arshin, kurse njerëzit, përndryshe kanë lindur pas Ademit më të vegjël e më të vegjël". Ekziston pajtueshmëri në autenticitetin e këtij hadithi.

Në Xhami'un e Tirmidhiut është shënuar nga Mu'adhi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Të gjithë banorët e Xhenetit do të hyjnë në Xhenet me një madhësi, me syrme në sy, dhe në moshë tridhjet e tri vjeçare".

Më parë është thënë se grupi i parë i besimtarëve që do të hyjnë në Xhenet do të jenë me fytyra të shndritura sikur hëna e plotë dhe se ngjyra e lëkurës (trupit) do t'u shndritë siç shndritë ylli më i shndritshëm në qiell.

Kur është në pyetje karakteri i banorëve të Xhenetit, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَنَزَعْنَا مَا فِي صُدُورِهِمْ مِنْ غَلٍّ إِخْوَانًا عَلَىٰ سُرُرٍ مُتَقَابِلِينَ﴾

“Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar”.⁶⁵

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar transmetimi: “Karakter i tyre do të jetë i njëllajtë sipas shembullit të babait të tyre, Ademit”.



⁶⁵ El-Hixhër: 47.

KAPITULLI I TETËMBËDHJETË

POZITA MË E LARTË DHE MË E ULËT NË XHENET

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ مِنْهُمْ مَنْ كَلَّمَ اللَّهُ وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ

دَرَجَاتٍ...﴾

“Këta (për të cilët të rrëfyem) janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët, prej tyre pati që Allahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë...”.⁶⁶

Muxhahidi dhe disa komentatorë të Kur’anit thonë se fjalët: “Prej tyre pati që Allahu u foli” kanë të bëjnë me Musain, alejhi selam, kurse fjalët: “Disa i ngriti në shkallë më të lartë”, me Muhamedin, salallahu alejhi ve selem. Më parë është cekur edhe hadithi për vesilen.

Në Sahihun e Muslimit është shënuar nga El-Mugire ibën Shu’be, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “E pyeti Musai Zotin e tij: ‘Cilët janë banorët me pozitën më të ulët në Xhenet?’. Ai, subhanehu ve teala, i tha: ‘Ai është njeriu që vjen pasi që kanë hyrë banorët e Xhenetit në Xhenet, e i thuhet atij: ‘Hyr në Xhenet!’. Thotë: ‘O Zot, si do të hyjë kur njerëzit i kanë zënë vendet e tyre dhe i kanë marrë gjërat e tyre?’. I thuhet atij: ‘A je i kënaqur që të posedosh sa prona e një mbreti nga mbretërit e dynjasë?’. Thotë: ‘Jam i kënaqur, o Zot’. (Allahu) I thotë: ‘Ti ke aq sa ai (mbreti), sa ai, sa ai dhe sa ai’. Në të pestën (herë) ai thotë: ‘Jam i kënaqur, o Zot!’. I thotë: ‘Ti ke ate dhe dhjetë herë sa ajo dhe aty ke

⁶⁶ El-Bekare: 253.

çfarë shpirti të dëshirojë dhe syri të lakmojë'. Thotë: "Jam i kënaqur, o Zot!". Musai, alejhi selam, tha: 'O Zot, cila është pozita e atyre që kanë vendet më të larta në të'. Tha: 'Ata janë që unë i dëshirova, fisnikërinë e tyre e mbjella me dorën Time dhe e vulosa atë. (Për ata) Në të ka çfarë syri nuk ka parë, veshi nuk ka dëgjuar dhe zemra e njeriut nuk ka paramenduar'".

Në *Sahihun* e Tirmidhiut është shënuar nga Ibën Omeri, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Vendbanimi më i ulët në Xhenet është ai ku banori i tij do të mund të shikojë kopshtet e tij, gratë, begatitë, shërbëtoret dhe divanet e tij; kurse udhëtimi nëpër te zgjatë një mijë vjet. Pozitën më të lartë te Allahu do ta ketë ai që do ta shikojë fytyrën e Tij në mëngjes dhe mbrëmje. Pastaj Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e lexoi ajetin:

﴿وَجُودَ يَوْمَئِذٍ نَاصِرَةٌ ﴿٦٦﴾ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاطِرَةٌ ﴿٦٧﴾﴾

"Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara).
Që Zotin e tyre e shikojnë".⁶⁷

⁶⁷ El-Kijame: 22, 23.

KAPITULLI I NËNTËMBËDHJETË

EZANIN QË DO TA THËRRET MUEZINI I XHENETIT

Muslimi ka shënuar nga Ebu Se'idi dhe Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Thirrësi do të thërret: *Erdhi koha të jeni të shëndoshë dhe kurrë më të mos sëmureni, erdhi koha të jetoni dhe kurrë më të mos vdisni, erdhi koha të jeni të rinj dhe kurrë më të mos plakeni dhe erdhi koha të kënaqeni dhe kurrë më të mos jeni të dëshpruar*".

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Allahu i Lartësuar u thotë banorëve të Xhenetit: 'O banorë të Xhenetit'. Thonë: 'Ty të përgjigjemi, o Zoti ynë dhe krejt hajri është në dorën Tënde'. U thotë: 'A jeni të kënaqur?'. Thonë: 'E pse mos të jemi të kënaqur o Zot, kur Ti na dhurove çka nuk i dhurove askujt'. U thotë: 'A t'ju dhuroj diçka më të mirë se sa kjo?'. Thonë: 'O Zot, çka ka më të mirë se sa kjo?'. U thotë: 'Ju përfshij me kënaqësinë time dhe kurrë më nuk hidhërohem ndaj jush'".

KAPITULLI I NJËZETË

DRUNJTË, FRUTET DHE LUMENJTË E XHENETIT

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَأَصْحَابُ الْيَمِينِ مَا أَصْحَابُ الْيَمِينِ ﴿٦٨﴾ فِي سِدْرٍ مَّخْضُودٍ ﴿٦٩﴾ وَطَلْحٍ مَّنضُودٍ ﴿٧٠﴾ وَظِلِّ مَمْدُودٍ ﴿٧١﴾ وَمَاءٍ مَّسْكُوبٍ ﴿٧٢﴾ وَفَاكِهَةٍ كَثِيرَةٍ ﴿٧٣﴾ لَّا مَقْطُوعَةٍ وَلَا مَمْنُوعَةٍ ﴿٧٤﴾

"E për sa u përket atyre të djathtëve, çka është gjendja e të djathtëve? Janë nën drunj të pemëve pa therra (pa gjemba). Të bananeve me fruta palë-palë. Nën hije të përherëshme. Pranë ujit rrjedhës. Edhe ndër pemë shumë llojesh. Që as nuk ndërprehen, as nuk janë të ndaluara".⁶⁸

I Lartësuar po ashtu thotë:

﴿ فِيهِمَا فَاكِهَةٌ وَنَخْلٌ وَرُمَّانٌ ﴿٧٥﴾

"Aty, në ata të dy, ka hurma dhe shegë".⁶⁹

Fjala *mahdud* në ajetin e 28-të të sures El-Vakia (që u cek më parë) ka kuptim ajo nga e cila janë larguar therrat (gjembat). Fjala *talh* në ajetin 29-të të së njëjtës sure sipas shumicës së komentatorëve të Kur'anit, ka kuptimin e drurit të bananes. Ky është, po ashtu, qëndrim i Aliut, Ibën Abasit, Ebu Hurejres dhe Ebu Se'idit.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Në Xhenet ka dru nën hijen e të cilit kalorësi udhëton njëqind vjet,

⁶⁸ El-Vakia: 27-33.

⁶⁹ Er-Rrahman: 68.

kurse hija nuk mbaron". Hadith i ngjashëm është shënuar nga Ebu Se'idi dhe Sehël ibën Sa'di në veprat e haditheve që u cekën.

Në *Musnedin* e Ahmed ibën Hanbelit është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Në Xhenet ka dru nën hijen e të cilit kalorësi udhëton shtatëdhjetë ose njëqind vjet, ky është druri i Xhenetit të amshueshëm (përjetësisë)".

Në *Xhami'un* e Tirmidhiut është shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Nuk ka asnjë pemë në Xhenet përveç se trungu i saj të jetë nga ari". Tirmidhiu hadithin e ka vlerësuar si *hasen* (të mirë).

Ebu Ja'la el-Mevsili në *Musned* ka shënuar nga Esmat: "E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, duke e përmendur suren El-Munteha dhe ka thënë: 'Udhëtari udhëton nën hijen e degëve të tij njëqind vjet' ose ka thënë: 'Udhëtari është nën hijen e degëve të tij njëqind vjetë, truallin e ka nga ari, kurse hurma sikur një kullë". Hadithin e transmeton Tirmidhiu dhe thotë se është *hasen* (i mirë).

Frutet e Xhenetit dhe veçoritë e tyre

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿... كَلَّمَا رَزَقُوا مِنْهَا مِنْ ثَمَرَةٍ رَزَقُوا قَالَُوا هَذَا الَّذِي رَزَقْنَا مِنْ قَبْلُ وَأَنُوبُوا بِهِ مُتَشَابِهًا... ﴿٧٦﴾

"Çdo herë që do t'u shërbehet me fruta të tij, ata do të thonë: Këta janë nga ç'na është shërbyer më parë, e atyre do t'u jepen gjëra të ngjashme (në formë, por me shije të ndryshme)".⁷⁰

⁷⁰ El-Bekare: 25.

Fjalët e tyre: "Këta janë nga ç'na është shërbyer më parë", kanë kuptim: "të ngjashme me këto", por jo këto të njëjtat. Për fjalët: "e atyre do t'u jepen gjëra të ngjashme", Hasani thotë: "Të gjitha frutat do të jenë të kualitetshme, nuk do të ketë fallso (një gjë që e neverisim). A nuk e shihni se disa frute të kësaj dynjaje njerëzit duhet t'i bëjnë falls?!" Të njëjtit mendim janë Katadeja dhe Ibën Xhurejxhi. Ibën Mes'udi, Ibën Abasi dhe një grup i sahabëve konsiderojnë se fjalët e cekura kur'anore kanë kuptim: "të ngjashme me ngjyrë dhe formë, por jo edhe me shije". Jahja ibën Ebu Kethiri thotë: "Bari në Xhenet është shafran, kurse rëra e tij është nga miski. Rreth banorëve të tij do të sillen fëmijë me fruta të cilat do t'i hanë ata, e pastaj do t'u sjellin fruta të ngjashme, e ata do të thonë: "Na i keni sjellur këto më parë". Shërbëtorët do t'u thonë: "Hani, ngjyra është e njëjtë, por shija është e ndryshme".

Taberaniu ka shënuar nga Theubani se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kur njeriu e vjel frutin në Xhenet, në atë vend do të paraqitet frut i ri".

Ibën Mubareku thotë: "Ka thënë Ibën Abasi, radijallahu anhu: Frutet e Xhenetit janë sikur (me madhësi) qypi dhe sheke, janë më të bardha se qumështi, më të ëmbël se mjalti, më të buta se gjalpi dhe në to nuk ka fara".

Bujqësia në Xhenet

Buhariu ka shënuar në *Sahihun* e tij, në kapitullin mbi teuhidin se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, një ditë në prezencë të një beduini (fshatari) ka thënë: "Një banor i Xhenetit do të kërkojë nga Zoti i tij i Madhëruar që ta punojë tokën, e Ai do t'i thotë: 'A nuk e ke gjithë atë që e ke dëshiruar?'. Njeriu do t'i thotë: 'Sigurisht, por unë dua ta punoj tokën'. Pastaj do të nxiton ta mbjellë dhe t'i kushtohet pjekjes dhe korryes së saj, dhe frutet do të bëhen dhe do të duken sikur një

kodër. Allahu i Lartësuar do t'i thotë: Ja o njeri, ty asgjë nuk mund të të ngopë!".

Kjo tregon se në Xhenet do të punohet dhe do të mbjellët toka, dhe se kjo farë do të jetë prej Xheneti. Kjo sugjeron se është mirë të mbillet toka me pemë, perime dhe mbjella të ndryshme. Nuk më është e njohur se mbjellja e tokës në Xhenet të jetë përmendur dikund tjetër, pos në këtë hadith, kurse Allahu e di më së miri.

Burimet dhe lumenjtë e Xhenetit

Në Kur'an shpesh përmenden fjalët e Allahut të Lartësuar: "...janë në Xhenet, ku rrjedhin lumenj...". Në një vend tjetër qëndron: "...janë në Xhenet, ku rrjedhin lumenj...". Kurse në një tjetër thuhet:

﴿...تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمُ الْأَنْهَارُ...﴾

"Ku rrjedhin lumenj".⁷¹

Këto ajete udhëzojnë në tri gjëra: e para, në Xhenet ka lumenj, e dyta: këto lumenj rrjedhin e nuk qëndrojnë me një vend, dhe e treta: ato rrjedhin nën dhoma, pallate dhe kopshtet e banorëve të Xhenetit.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فِيهِمَا عَيْنَانِ نَضَّاخَتَانِ﴾

"Aty janë dy burime që gjithnjë gurgullojnë".⁷²

Ibën Ebu Shejbe transmeton nga Se'idi: "(Ka për qëllim dy burime të cilat) kanë shumë ujë dhe frute". Nga Enesi, radijallahu anhu, transmetohet: "Në pyetje janë dy burime që stërpikin me misk dhe amber në shtëpitë e

⁷¹ El-A'raf: 43.

⁷² Er-Rrahman: 66.

banorëve të Xhenetit, siç bie shiu nëpër shtëpitë e njerëzve në këtë botë”.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَثَلُ الْحِنَّةِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ فِيهَا أَنْهَارٌ مِنْ مَاءٍ غَيْرِ آسِنٍ وَأَنْهَارٌ مِنْ لَبَنٍ لَمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ وَأَنْهَارٌ مِنْ خَمْرٍ لَذَّةٍ لِلشَّارِبِينَ وَأَنْهَارٌ مِنْ عَسَلٍ مُصَفًّى وَلَهُمْ فِيهَا مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِنْ رَبِّهِمْ كَمَنْ هُوَ خَالِدٌ فِي النَّارِ وَسُقُوا مَاءً حَمِيمًا فَقَطَّعَ أَمْعَاءَهُمْ﴾

“Shembulli i Xhenetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur (të devotshëm), në të cilin ka lumenj me ujë të mirë për pije, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pemësh, kanë edhe falje nga Zoti i tyre (a është i njëjtë) si ai që është përgjithmonë në zjarr dhe u shuhet etja me ujë të valë që ua copëton zorrët e tyre?”.⁷³

Allahu, subhanehu ve teala, në këtë ajet i përmend katër lloje të lumenjve dhe përjashton mundësinë e çdo dëmi prej tyre, nga të cilat njerëzit kanë qenë të ekspozuar ndonjëherë në këtë botë.

Lumenjt e Xhenetit burojnë në shkallën më të lartë të tyre, e pastaj lëshohen drejt shkallëve më të largëta.

Buhariu ka shënuar nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Në Xhenet ka njëqind shkallë të cilat Allahu i ka përgatitur për muxhahidët që luftuan në rrugën e Tij. Hapësira mes dy shkallëve është aq sa është hapësira mes qiellit dhe tokës. Kur të kërkoni prej Allahut (gjatë lutjes), kërkoheni ‘Firdeusin’, sepse ai është mesi dhe grada më e lartë e Xhenetit. Mbi të (Firdeusin) është Arshi (froni) i Gjithëmëshiruesit (Er-Rrahmanit) dhe prej tij burojnë lumenjtë e Xhenetit”.

⁷³ Muhamed: 15.

Në Sahihun e Buhariut është shënuar nga Enesi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Duke ecur unë në Xhenet pashë një lumë që brigjet e tij ishin kupolla (çadra) nga margaritari i tharë. Thashë: Ç’është ky o Xhibril? Tha: Ky është Keotheri që Zoti yt ta dhuroi. Çfarë të shohësh, aroma apo dheu i tij ishte nga misku aromatik”.

Në Sahihun e Muslimit është shënuar nga Enesi, radijallahu anhu, se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Keotheri është lum në Xhenet të cilin ma ka premtuar Zoti i Madhëruar”.

Sa i përket burimeve të Xhenetit, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ﴾

“E ata, të cilët iu ruajtën (mosbesimit dhe punëve të këqija) janë në Xhenete e mes burimeve”.⁷⁴

Në ajetin tjetër qëndron:

﴿عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا عِبَادُ اللَّهِ يُفَجِّرُونَهَا تَفْجِيرًا﴾

“Është një burim prej të cilit pijnë robërit e Allahut dhe e bartin atë ku të duan”.⁷⁵

Allahu, subhanehu ve teala, po ashtu thotë:

﴿وَيُسْقَوْنَ فِيهَا كَأْسًا كَانَ مِزَاجُهَا زَنْجَبِيلًا ﴿٦٥﴾ عَيْنًا فِيهَا تُسَمَّى سَلْسَبِيلًا﴾

“Dhe u jepet të pijnë aty gota të verës të përziara me zenzhebilë (bimë aromatike). (nga) Burim aty që quhet selsebil (i lehtë në të pirë)”.⁷⁶

Kështu i Lartësuar, me atë që e ka emërtuar burimin nga i cili ekskluzivisht pijnë ata që janë në afërsi të Tij, në

⁷⁴ El-Hixhër: 45.

⁷⁵ El-Insan: 6.

⁷⁶ El-Insan: 17, 18.

realitet edhe ka treguar se pijet e robërve të Allahut janë përgatitur nga i njëjti burim.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

﴿...وَسَقَاهُمْ رَبُّهُمْ شَرَابًا طَهُورًا﴾

"...dhe Zoti i tyre do t'u japë për të pirë pije të pastër".⁷⁷

Ky është zbulim i brendësisë, i pastruar nga çdo pakënaqësi dhe e metë.



⁷⁷ El-Insan: 21.

KAPITULLI NJËZET E NJË

USHQIMI, PIJET DHE RROBAT E BANORËVE TË XHENETIT

Ushqimi dhe pijet e banorëve të Xhenetit

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

﴿فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ ﴿۷۸﴾ فِي حَتَّةٍ عَالِيَةٍ ﴿۷۹﴾ قُطُوفَهَا دَانِيَةٌ ﴿۸۰﴾ كُلُّوا ﴿۸۱﴾ وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا أَسْلَفْتُمْ فِي الْأَيَّامِ الْخَالِيَةِ ﴿۸۲﴾﴾

"Dhe ai atëherë është në një jetë të kënaqshme. Në një Xhenet të lartë. Pemët e tij i ka krejt afër. (E thuhet) Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë".⁷⁸

Allahu, subhanehu ve teala, në një ajet tjetër thotë:

﴿...أَكَلَهَا دَأِيمًا وَظِلَّهَا...﴾

"...ushqimi në të dhe hija në të është e përhershme...".⁷⁹

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

﴿وَأَمَّا ذُنُوبُهُمْ فَبِأَكْبَرِهِمْ وَلَحْمٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ ﴿۸۳﴾ يَتَنَزَّعُونَ فِيهَا كَأَسَا لَّا لَعُونُ ﴿۸۴﴾ فِيهَا وَلَا تَأْتِيهِمْ ﴿۸۵﴾﴾

"Ne atyre ua shtojmë të mirat me pemë e me mish që ata e dëshirojnë. Aty njëri-tjetrit ia zgjasin gotën, aty nuk ka fjalë të kota e as mëkat".⁸⁰

⁷⁸ El-Haka: 21-24.

⁷⁹ Er-Rrad: 35.

Më Sahihun e Muslimit është shënuar nga Xhabiri, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Banorët e Xhenetit hanë, pinë, nuk pështynë, nuk derdhin ujë, nuk kryejnë nevojën dhe nuk u rrjedhin hundët"*. Thanë (shokët e tij): *"E çfarë bëhet me ushqimin?"*. Tha: *"Bëhet lëndë e ngjirur sikur të ngjirurit e miskut"*.

Në Musnedin e Ahmed ibën Hanbelit dhe Sunenin e Nesaiut është shënuar hadithi, transmetuesit e të cilit i plotësojnë kushtet e përmbledhjeve të haditheve autentike ku Zejd ibën Erkami thotë: *"Erdhi një pasues i Librit te Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe e pyeti: "O Ebul Kasim, a do të hanë dhe pinë banorët e Xhenetit?"*. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u përgjigj: *"Po, pasha Ate në dorën e të Cilit është shpirti im, secilit prej tyre do t'u jepet fuqia e njëqind njerëzve në ushqim, pije dhe marrëdhënie intime"*. Por, ai që hanë dhe pinë duhet edhe të kryejë nevojën, kurse në Xhenet nuk ka pakënaqësi", vërejtja pasuesi i Librit. I Dërguari, salallahu alejhi ve selem, tha: *"Nevoja e secilit prej tyre do të jetë djersë që do të del nga lëkura e tyre, dhe do të ketë aromë të miskut"*.

Hakimi ka shënuar qëndrimin e Ebu Derdasë, radijallahu anhu, për fjalët e Allahut të Lartësuar "Aroma e tij është misk": *"Ajo është pije, e bardhë sikur argjendi, me të cilën banorët e Xhenetit do ta mbarojnë pirjen e tyre. Sikur njeriu, banor i kësaj bote, ta fusë dorën e tij në te, e pastaj e nxjerr, çdo gjë që ka shpirt do ta ndjente mirësinë (bukurinë) e kësaj arome"*.

Ademi thotë se transmetohet nga Ata'i se ka thënë: *"Teshim është burim i cili përzihet me verë"*. Imam Ahmedi ka shënuar nga Ibën Abasi, radijallahu anhu, se për fjalët e Allahut të Lartësuar "ia zgjasin gotën": *"Do të pasojnë njëra pas tjetrës të plota"*.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ يُطَافُ عَلَيْهِمْ بِصِحَافٍ مِّنْ ذَهَبٍ وَأَكْوَابٍ... ﴾

"Atyre u shërbejnë me enë e gastare nga ari...".⁸¹ Në një ajet tjetër thotë:

﴿ يَطُوفُ عَلَيْهِمْ وِلْدَانٌ مُّخَلَّدُونَ ﴿١٠﴾ بِأَكْوَابٍ وَأَبَارِيقٍ وَكَأْسٍ مِّنْ مَّعِينٍ ﴿١١﴾

"Atyre u shërbejnë djelmosha të gjithmonshëm. Me gastare, me ibrik dhe me gota të mbushura plot prej burimit".⁸² Buhariu në Sahihun e tij thotë: *"Ibrikët janë gota që kanë feçka, e nëse nuk kanë feçka dhe dorëza, atëherë ato janë gota të thjeshta"*.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَيُطَافُ عَلَيْهِمْ بِآيَةٍ مِّنْ فِضَّةٍ وَأَكْوَابٍ كَانَتْ قَوَارِيرًا ﴿١٢﴾ قَوَارِيرٍ مِّنْ فِضَّةٍ قَدَرُوهَا تَقْدِيرًا ﴿١٣﴾

"Dhe atyre u bëhet shërbim me enë të argjendta dhe me gota të tejdukshme. Të tejdukshme nga argjendi që ata (shërbëtorët) i përcaktuan të jenë sa duhet (të mëdha o të vogla)".⁸³ Allahu, subhanehu ve teala, këtu flet për materialin nga të cilat do të jenë enët, dhe ka të bëjë me argjend që ka cilësi të xhamit dhe tejdukshmërinë e tij.

Ibën Abasi, radijallahu anhu, thotë: *"Në këtë botë nuk ka asgjë që ka në Xhenet, vetëm emrat janë të njëjtë. Gotat në këtë botë mund të jenë nga argjendi dhe të tejdukshme. Mirëpo, Allahu, subhanehu ve teala, na lajmëron se gotat në Xhenet do të jenë nga argjendi i bardhë dhe në të njëjtën kohë të tejdukshme"*.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Musa, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Për"*

⁸¹ Ez-Zuhuf: 71.

⁸² El-Vakia: 17, 18.

⁸³ El-Insan: 15, 16.

⁸⁰ Et-Tur: 22, 23.

besimtarët në Xhenet ka një tendë prej xhevahirit të thatë... dhe dy Xhenete nga argjendi bashkë me enët dhe çfarë ka në to, dhe dy Xhenete prej arit bashkë me enët dhe çfarë ka në to. Njerëzit në Xhenetin 'adn nga shikimi në Zotin, i ndan vetëm perdja e madhërisë në Fytyrën e Tij".

Rrobat dhe shtrati i banorëve të Xhenetit

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

﴿يَلْبَسُونَ مِنْ سُندُسٍ وَإِسْتَبْرَقٍ مُتَقَابِلِينَ﴾

"Veshin petka nga mëndafshi e kadifeja, ulur ballë për ballë".⁸⁴ Në një ajet tjetër Ai thotë:

﴿يُحَلَوْنَ فِيهَا مِنْ أَسَاوِرَ مِنْ ذَهَبٍ وَيَلْبَسُونَ ثِيَابًا خُضْرًا مِنْ سُندُسٍ وَإِسْتَبْرَقٍ مُتَكِينٍ فِيهَا عَلَى الْأَرْكَانِ نَعْمَ الثَّوَابُ وَحَسُنَتْ مُرْتَفَعًا﴾

"...aty stolisen me rrahtë të artë dore dhe ata veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e të trashë, janë mbështetur aty në shtretër...".⁸⁵

Një grup dijetarësh thonë: "Sundus është produkt mëndafshi, kurse istebrek është material më i ashpër se sundusi". Të tjerët thonë se me këtë nuk ka për qëllim ashpërsinë, por materialin e endur fortë (të dendur).

Nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, transmetohet një hadith i vërtetë ku thuhet se ai që veshë tesha të mëndafshit në këtë botë, nuk do të veshë në botën e ardhshme. Një grup dijetarësh nga gjeneratat e hershme konsiderojnë se nuk do të veshin mëndafsh, por do të veshin diç tjetër. Ata thonë: "Pendimi e largon realizimin e kanosjes. Po ashtu, punët e mira i fshijnë mëkatet, musibe-

⁸⁴ Ed-Duhan: 53.

⁸⁵ El-Kehf: 31.

tet, duaja e muslimanit dhe ndërmjetësimi i atij që Allahu e lejon të ndërmjetësojë te Ai".

Ibën Ebi Dunja ka shënuar nga Ebu Umame, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kush prej juve hyn në Xhenet, do të dërgohet në Tuba, ai do t'ia hapë petlat e sajë - nga ajo ai do të mund të merr me ngjyrë të bardhë, të kuqe, të gjelbërt, cilën ta dëshirojë. Ato petla janë sikur të anemonës së kuqe, vetëm se janë më të bukura dhe më delikate".

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Enesi, radijallahu anhu: "Ukejdir Duma i dhuroi Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, një xhube nga mëndafshi, e njerëzit mahniteshin me bukurinë e saj. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, tha: *Faculetat e Sa'dit në Xhenet janë më të mira se kjo!*".

Kur bëhet fjalë për shtrojet, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مُتَكِينِينَ عَلَى رَفْرَفٍ خُضْرٍ وَعَبْقَرِيٍّ حِسَانٍ﴾

"Dhe pushojnë në jastëk të gjelbër dhe shtroje të bukura e të buta".⁸⁶

Ai, subhanehu ve teala, po ashtu thotë:

﴿فِيهَا سُرُرٌ مَرْفُوعَةٌ وَأَكْوَابٌ مُوَضَّعَةٌ وَنَخَارِقٌ مَصْفُوفَةٌ وَزُرَابِيٌّ مُبْتُوثَةٌ﴾

"Aty kanë shtretër të lartë. Dhe gastare të vëna pranë, edhe jastëkë të renduar për mbështetje, edhe qilima të shtruar".⁸⁷

Se'id ibën Xhubejri thotë: "Refref janë kopshte, kurse el-'abkarij qilimë me vlerë të madhe". El-Vahidi thotë: "Nemarik janë jastëke". El-Kelebiu thotë: "Fjala zerabij nënkupton tepihët dhe qilimat, kurse në njëjës thuhet zeri-

⁸⁶ Er-Rrahan: 76.

⁸⁷ El-Gashije: 13-16.

beh". El-Lejisi thotë: "Refreh është lloj veshje e gjelbër dhe e zgjatur, mjaft komode. Në të njëjës është *refrefeh*". Për shprehjen 'abkarij Ebu Ubejde thotë: "Për çdo gjë që shtrohet thuhet 'abkarij. Arabët, kur diç dojnë të dimensionojnë tepër e lidhin për shprehjen 'Abkar, toka e çudirave, që e banojnë xhinët".

Es-sururu'l-merfuah (shtretër të lartë) - janë ato që janë thurur shumëfish.

Shërbëtorët

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ وِلْدَانٌ مُّخَلَّدُونَ إِذَا رَأَيْتَهُمْ حَسِبْتَهُمْ لُؤْلُؤًا مَّنثُورًا ﴾

"Dhe atyre u sillen për shërbim djelmosha që përherë janë të tillë sa që kur t'i kundrosh të duken si margaritarë të derdhur".⁸⁸

Ebu Ubejde thotë: "Muhul-ledun don të thotë se nuk do të plaken, e as që do të ndryshojnë".

Dijetarët janë ndarë në mendime rreth asaj se shërbëtorët a do të jenë fëmijë prej kësaj bote apo Allahu do t'i krijojë në Xhenet për herë të parë. Aliu dhe Hasani thonë: "Këta do të jenë fëmijët e muslimanëve". Disa prej dijetarëve konsiderojnë se këta do të jenë fëmijët e politeistëve. Më e drejtë do të ishte që ata të jenë fëmijë të krijuar në Xhenet, si hyritë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Do t'i shërbejnë shërbëtorët e tyre", dhe këta nuk do të jenë fëmijët e tyre. Allahu do t'ua plotësojë begatitë me ate që edhe fëmijët e tyre do të shërbehen bashkë me ta.

⁸⁸ El-Insan: 19.

KAPITULLI I NJËZET E DYTË

GRATË E BANORËVE TË XHENETIT

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...وَلَهُمْ فِيهَا أَزْوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ وَهُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴾

"Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë".⁸⁹ Allahu, subhanehu ve teala, ua ka bashkuar banorëve të Xhenetit kënaqësitë e trupit, me kopshtet e Xhenetit dhe atë që është në to, kënaqësitë e pasionit, me gra të pastërta dhe kënaqësinë e zemrës, me njohurinë se kjo jetë do të zgjatë përgjithmonë.

Mutahereh don të thotë: ato që do të jenë të pastërta nga menstruacionet, urinimi, nevoja e madhe, gjakderdhja pas lindjes dhe papastërtive tjera që i kanë gratë në këtë botë; brendësia e tyre do të jetë e pastër nga e keqja, gjuha nga paturpësia; shikimi do t'u jetë i pastër nga shikimet ndaj ndokujt tjetër pos ndaj burrave të tyre, kurse rrobat do t'u jenë të pastërta nga llumi dhe ndytësira.

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë:

﴿ كَذَلِكَ وَزَوَّجْنَاهُم بِحُورٍ عِينٍ ﴾

"Ja kështu, edhe i martojmë me bardhoshe symëdhja (me hyri)".⁹⁰

Havra' (shum. Hur) don të thotë grua e re, me bukuri të jashtëzakonshme me sy të zinj. Zejd ibën Eslemi thotë: "Havra' don të thotë ajo që të habitë me shikimin e saj, kurse 'in janë sytë më të bukur".

⁸⁹ El-Bekare: 25.

⁹⁰ Ed-Duhan: 54.

Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿ فِيهِنَّ قَاصِرَاتُ الطَّرْفِ لَمْ يَطْمِئِنَّهُنَّ أَنَسَ قُلُوبُهُنَّ وَلَا جَانٌ ﴾

"Aty janë ato që përqendrojnë shikimet e tyre...".⁹¹ Muxhahidi i komenton në këtë mënyrë: "Ato që shikojnë vetëm në burrat e tyre dhe nuk lakmojnë për burra tjerë". Hasani thotë: "Nuk stolisen, nuk zbukurohen dhe nuk ua tërheqin vëmendjen të tjerëve".

Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿ إِنَّا أَنشَأْنَاهُنَّ إِنشَاءً ﴾

"Ne i kemi krijuar ato në një krijim të ri (formë të re)".⁹² Katadeja dhe Se'id ibën Xhubejri i komentojnë në këtë mënyrë: "Do t'i krijojmë në formë të re". Ibën Abasi thotë: "Ka për qëllim gratë nga lloji i njerëzve". El-Kelbi thotë: "Ka për qëllim plaka të thinjura", e këtë e vërteton hadithi *merfu'* të cilin e transmeton Enesi, radijallahu anhu: "Ato janë plakat e juaja të zglebura, shikimdobëta". Pos kësaj ai cekë edhe pikëpamjen e dytë: "Ato janë hyritë me sy të mëdhenj, të cilat Allahu i ka krijuar për të dashurit e tij, të cilat askush më parë nuk i ka prekur!".

'Urub është shumësi i fjalës 'arub, që do të thotë, ajo që është e dashur për burrin e saj. Edhe Buhariu në *Sahihun* e tij thotë se njëjësi i fjalës së cekur është 'arub. Mekelinjtë për gruan e tillë thonë 'ariba (e dashur), ndërsa medinelinj-të *fenixha*, kurse irakianët *shekila* (lozonjare).

Buhariu në *Sahihun* e tij ka shënuar nga Enesi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Sikur të dilte (paraqitej) në tokë një grua e Xhenetit do ta mbushte me aromë çka ka mes Xhenetit dhe

⁹¹ Er-Rahman: 56.

⁹² El-Vakia: 35.

Tokës dhe do ta ndriçonte, vetëm shamia në kokën e saj është më e mirë (më e vlefshme) se gjithë bota dhe çka në të".

Taberaniu ka shënuar nga Umu Seleme: "Thashë: O i Dërguar i Allahut, mi komento fjalët e Allahut të Lartësuar: *hurin 'in* (Hyritë me sy të mëdhenj). Pejgamberi tha: '*Hurun* do të thotë bardhësi, kurse '*in* do të thotë '*sy të mëdhenj të zi*'. Pastaj thashë: Mi komento fjalët e Tij: *Fihine hajratun hisan* (Aty janë ato (gra) të ndershme e të bukura).⁹³ Pejgamberi tha: Ka për qëllim gratë me karakter të mirë dhe fytyra të bukura. Pastaj i thashë: Më lajmëro për fjalët e Tij: *Ke enehune bejdun meknun* ((Të brishta, të pastra) si të ishin vezë (të fshehura) të ruajtura mirë).⁹⁴ Pejgamberi tha: Ato janë të buta (ndieshme) sikur lëkurëza që e sheh në vezë nën gërzhole. Thashë: Mi spjego fjalët e Tij: '*Uruben etraba* (Të dashuruara (për burrat e vet)).⁹⁵ Ai i komento: 'Ato janë që e kanë lëshuar këtë botë sikur plaka të zglebura dhe thinjura! Ato Allahu do t'i bëjë virgjëresha, të këndshme, të dashuruara për burrat e tyre, të së njëjtës moshë! Pastaj pyeta: A janë më të mira gratë e kësaj bote apo hyritë me sy të mëdha? Pejgamberi u përgjigj: Sigurisht, gratë e kësaj bote për shkak të namazit të tyre, agjërimit dhe ibadeteve të tyre, Allahu fytyrave të tyre do t'u jep shkëlqim dhe trupin e tyre do ta veshë me mëndafsh. Po ashtu e pyeta: O i Dërguar i Allahut, si është puna e gruas që është martuar dy herë (me dy burra) apo më shumë, cili do të jetë burri i saj (në Xhenet)? Pejgamberi u përgjigj: Ajo do të mund të zgjedh, dhe do ta zgjedh atë që ka sjellje më të mirë, oj Umu Seleme, sjellja e mirë është e mirë në këtë botë dhe në botën tjetër".

⁹³ Er-Rrahman: 70.

⁹⁴ Es-Safat: 49.

⁹⁵ El-Vakia: 37.

Shtatzënia (graviditeti) dhe lindja e fëmijëve në Xhenet

Dijetarët ndahen në mendime rreth asaj se a do të ketë në Xhenet lindje të fëmijëve apo jo. Disa thonë se në Xhenet do të ketë marrëdhënie intime, por jo edhe lindje. Ky është qëndrim i Tavusit, Muxhahidit dhe Ibrahim en-Neh'ut.

Buhariu ka shënuar nga Is'hak ibën Ibrahim: "Sikur besimtari të dëshironte fëmijë në Xhenet, do ta kishte ashtu siç ai e ka dëshiruar, por atë nuk do ta dëshirojë".

Disa thonë se besimtari do të ketë fëmijë nëse këtë ai e dëshiron, duke u bazuar në hadithin të cilin Tirmidhiu e ka shënuar nga Ebu Se'idi: "Dikush ka pyetur: O i Dërguar i Allahut, a do të kenë fëmijë banorët e Xhenetit? Ai është përgjigjur: Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im mjafton që ndokush prej jush të dëshiron dhe do ta ketë të ngjizurit, gjidhënien dhe rritjen e tij!".

Mohimi i lindjes së fëmijëve në Xhenet bazohet në:

- fjalët e Allahut të Lartësuar: "*Ata aty do të kenë gra të pastërta*". Ka për qëllim se do të jenë të pastërta nga menstruacionet, lehonja dhe lindja.

- fjalët e Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem: "*Nuk do të ketë spermë, as vdekje*", si dhe në hadithin, autenticiteti i të cilit është vërtetuar: "Në Xhenet mbetet shërbimi. Allahu xhenetlinjëve do t'ua krijon disa qenie të cilat do t'i vendosë në Xhenet, dhe sikur në Xhenet të kishte lindje, shërbimi do t'u jepej fëmijëve të xhenetlijve!".

- transmetimin e Ebu Ruzejn el-'Ukajlijit: "Banorët e Xhenetit nuk do të kenë fëmijë".

KAPITULLI I NJËZET E TRETË

SHOQËRIMI I BANORËVE TË XHENETIT

Dëgjimi i banorëve të Xhenetit

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَهُمْ فِي رَوْضَةٍ يُحْبَرُونَ ﴾

"E ata, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, ata do të jenë të gëzuar në një kopsht (të Xhenetit)".⁹⁶

Ibën Xheriri ka shënuar se Jahja ibën Ebu Kethiri ka thënë: "*Habreh* nënkupton ëmbëlsi (ëndje) dhe dëgjim". Muxhahidi e komenton fjalën *juhberun* në ajetin e cekur me fjalën *jen'amun* (të gëzuarit, kënaqurit). Kurse ëndja e dëgjimit është pjesë e kënaqësisë.

Në Xhamiun e Tirmidhiut është shënuar nga Aliu, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "*Vërtet në Xhenet hyritë me sy të mëdhenj do të tubohen në një vend dhe (do të këndojnë) me zë të lartë, që do t'i dëgjojnë të gjitha krijesat, do të thonë: Ne jemi të përherëshme, asnjëherë nuk do të zhdukemi; ne jemi të mira, nuk ka kurrfarë dëmi prej neve; sa herë jemi të kënaqura, asnjëherë nuk zemërohemi. Lum për ate që është i yni dhe ne jemi të atij!*".

Ebu Ne'imi ka shënuar transmetimin e Ebu Hurejres, radijallahu anhu, për cilësitë e Xhenetit: "*Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: Në Xhenet ka dru trungu i të cilit është nga ari, kurse degët nga krizoliti dhe*

⁹⁶ Er-Rum: 15.

margaritarët, dhe kur i tundë era, ato dridhen. Dëgjuesit nuk do të dëgjojnë zë më të këndshëm se ky”.

El-Ferjabi ka shënuar nga Ebu Umame, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Pranë kokës dhe këmbëve të çdo njeriu që do të hyjë në Xhenet do të ulen dy hyri me sy të mëdhenj, të cilat do t’i këndojnë me zërin më të bukur që ndonjëherë e kanë dëgjuar njerëzit dhe xhinët, dhe nuk do të ketë instrumente (fyell) të shejtanit”.

Ata do të dëgjojnë diç edhe më të lartësuar se kjo, kur do të pushon dëgjimi i çdo gjëje tjetër. Kjo do të jetë atëherë kur do të dëgjonin të folurit e Allahut të Lartësuar, përshëndetjen e Tij dhe të drejtuarit e Tij atyre dhe kur do t’u lexohet fjalimi i Tij. E kur ta dëgjojnë prej Tij, do t’u duket sikur më parë të mos e kishin dëgjuar këtë. Në vazhdim do t’i cekim edhe disa hadithe për ta vërtetuar këtë që e thamë.

Vizita e ndërsjellë e banorëve të Xhenetit

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ يَتَسَاءَلُونَ ﴿٥٦﴾ قَالَ قَائِلٌ مِّنْهُمْ إِنِّي كَانَ لِي قَرِينٌ ﴿٥٧﴾ يَقُولُ أَأُنْزِلَ لِمَنْ أَلْفَنَّا وَمَنْ فِئْتَانًا يَلْعَابُونَ ﴿٥٨﴾ قَالَ هَلْ أُنْتُمْ مُطَّلَعُونَ ﴿٥٩﴾ فَاطَّلَعَ فَرَآهُ فِي سَوَاءِ الْحَبِيمِ ﴿٦٠﴾ قَالَ تَاللَّهِ إِن كِدْتَ لَتُرْدِينِ ﴿٦١﴾ وَلَوْلَا نِعْمَةُ رَبِّي لَكُنْتُ مِنَ الْمُخْضَرِّينَ ﴿٦٢﴾﴾

“I qasen njëri-tjetrit e bisedojnë, prej tyre njëri flet e thotë: Unë kam pasur njëfarë miku, thoshte: A je ti prej atyre që besojnë se kur të jemi vdekur, të jemi bërë dhë e eshtra të kalbur, do të jemi të shpërblyer për vepra? Ai (besimtari në Xhenet) thotë: A vini ju të shikojmë? Ai shikon dhe e vëren atë (mikon) në mes të Xhehenemit. Ai thotë: Pasha Allahun, për pak më rrëzove (në Xhehenem)

edhe mua. Dhe sikur të mos ishte dhuntia e Zotit tim, unë do të isha bashkë me ty në zjarr”.⁹⁷

Allahu i Lartësuar flet për atë se si banorët e Xhenetit do ta pyesin njëri-tjetrin për gjendjet në të cilat kanë qenë në dynja derisa nuk shikojnë në njeriun i cili e ka mohuar ringjalljen, i cili do të jetë në Xhehenem. Ky është komentimi më i qartë i ajetit të cekur. Ekzistojnë edhe dy komentime tjera:

1. Melekët do t’i pyesin banorët e Xhenetit; “A doni të shikoni?”. Këtë mendim e transmeton ‘Atai nga Ibën Abasi.

2. Allahu, subhanehu ve teala, do t’i pyes banorët e Xhenetit: “A doni të shikoni?”. I saktë është komenti i parë sipas të cilit pyetjen do t’ua parashtron besimtari bashkëbiseduesve të tij.

Taberaniu ka shënuar nga Ebu Umame: “Dikush e ka pyetur të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem: A do të vizitohen mes veti banorët e Xhenetit? Ai është përgjigjur: Xhenetlitë që janë në pozita më të larta do t’i vizitojnë ata në pozitat më të ulta, derisa xhenetlitë në pozitat më të ulta nuk do t’i vizitojnë ata në pozitat më të larta; me përjashtim të atyre që janë dashur në emër të Allahut, ata do të shikojnë ku të dojnë nga dy pozitat, me jastëqe në shalë!”.

Ibën Ebu’d-Dunja ka shënuar nga Aliu, radijallahu anhu: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: Në Xhenet është një dru nga i cili do të dalin kuaj të artë, të shaluar dhe me dizgjinë, të cilët nuk do të kenë nevoja biologjike, do t’i kalërojnë disa banorë të Xhenetit dhe do të fluturojnë me ta ku të dëshirojnë. Xhenetlitë me pozita më të ulta se ata do të pyesin: O Zoti ynë, pse këta robër Tu i ke veçuar me këto nderime? Do t’u përgjigjet: Ata janë falur natën derisa ju keni fjetur, kanë agjëruar derisa ju keni ngrënë, kanë dhënë sadaka derisa ju

⁹⁷ Es-Safat: 50-57.

keni qenë kopracë dhe kanë luftuar derisa ju jeni treguar frikacakë”.

Tregu i Xhenetit

Në Sahihun e Muslimit është shënuar nga Enesi, radija-llahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Vërtetë në Xhenet ka një treg në të cilin çdo të premtë takohen banorët e Xhenetit. Fryen një erë e veriut në fytyrat dhe rrobat e tyre, e cila do t’ua shton atyre edhe më tepër mirësinë dhe bukurinë. E kur të kthehen te familja (gratë) e tyre do t’ju thonë: ‘Pasha Allahun prej kur keni shkuar ju qenka shtuar mirësia dhe bukuria! Pasha Allahun edhe juve iu paska shtuar mirësia dhe bukuria’ - do t’ju përgjijgen ata”.



KAPITULLI I NJËZET E KATËRT

A DO TA SHOHIN XHENETLINJTË ZOTIN E TYRE TË LARTËSUAR DHE MADHËRUAR

Ky kapitull në librin tonë ka vend dhe rëndësi të jash-tëzakonshme në raport me kapitujt tjerë, sepse shikimi në fytyrën e Allahut është qëllimi dhe begatia më e madhe për të cilën besimtarët bëjnë gara. Të gjithë pejgamberët janë të pajtimit se shikimi i fytyrës së Allahut në botën tjetër është i vërtetë, kurse e mohojnë vetëm bidatçinjtë dhe heretikët, kjo sektë e devijimit, pasues të Iblisit të mallkuar. Në vijim do t’i përmendim argumentet që e vërtetojnë mundësinë e shikimit të Allahut:

1. Fjalët të cilat Allahu i Lartësuar ia drejtoi bashkë-biseduesit të Tij, Musait, alejhi selam:

﴿وَلَمَّا جَاءَ مُوسَى لِمِيقَاتِنَا وَكَلَّمَهُ رَبُّهُ قَالَ رَبِّ أَرِنِي أَنْظُرْ إِلَيْكَ قَالَ لَنْ نَرَاكِ وَلَكِنْ أَنْظُرْ إِلَى الْجَبَلِ فَإِنِ اسْتَقَرَّ مَكَانَهُ فَسَوْفَ نَرَاكِ فَلَمَّا كَلَّمَهُ رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكًّا وَخَرَّ مُوسَى صَعِقًا فَلَمَّا أَفَاقَ قَالَ سُبْحَانَكَ تُبْتُ إِلَيْكَ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُؤْمِنِينَ﴾

“Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohish Mua. Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërrmi, e Musait i ra të fikët”.⁹⁸

Do të ishte tejet absurde që bashkëbiseduesi i Allahut nga Zoti i tij të kërkojë diç që nuk i ka hije, ndërsa kërkesën e të cilit Allahu nuk e kontestoi - sikur të ishte në

⁹⁸ El-A'raf: 143.

pyetje diç absurde, Ai këtë sigurisht se do t'ia kishte kontestuar. Mirëpo, Allahu iu përgjigj: "Nuk do të Më shohësh!", nuk ka thënë: "Nuk mund të Më shohësh!". Pos kësaj, mohimin e Tij nuk e ka shoqëruar me pjesëzën për forcim, siç këtë e ka bërë në ajetin: "...ata kurrë nuk e dëshirojnë atë".⁹⁹

Më së shumti që mund të thuhet në këtë kuptim është se fuqitë e Musait në këtë botë nuk janë të arritshme për ta parë Allahun në këtë botë, e që në mënyrë plotësuese e shpjegon fakti se kodra, me gjithë fuqinë e tij, nuk do të mund të qëndronte sikur t'i paraqitej Ai në këtë botë, e si do të mund të qëndronte njeriu i dobët?

2. Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿ نَسَاؤُكُمْ حَرَّتْ لَكُمْ فَأَتُوا حَرَّتَكُمْ أَلَى شَيْتَمٍ وَقَدَّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ وَأَتَقُوا اللَّهَ
وَأَعْلَمُوا أَنَّكُمْ مُلَاقُوهُ وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ ﴾

"Dhe kini frikë Allahun dhe dijeni se do ta takoni Atë (në Botën e tjetër)".¹⁰⁰

Gjuhëtarët janë unanim në atë se takimi, kur ka të bëjë me shikimin e gjallë dhe të shëndoshë, nënkupton ballafaqim dhe shikim. Aq më tepër, ekzistojnë shumë hadithe që flasin për ate se Atë, subhanehu ve teala, në Ditën e Gjykimit kanë për ta parë munafikët dhe mosbesimtarët, siç është shënuar në Sahihet e Buhariut dhe Muslimit në hadithin që flet për paraqitjen e Allahut, të cilin do ta përmendim pak më vonë.

3. Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿ لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ وَلَا يَرْهَقُ وُجُوهَهُمْ قَتَرٌ وَلَا ذِلَّةٌ أُولَٰئِكَ
أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴾

⁹⁹ El-Bekare: 95.

¹⁰⁰ El-Bekare: 223.

"Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xheneti) edhe më tepër (e shohin Allahun)".¹⁰¹

Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, fjalët e Allahut, subhanehu ve teala, i komenton ve zijadeh do të thotë të shikuarit në fytyrën e Allahut të Lartësuar. Këtë komentim e ka shënuar Muslimi në Sahihun e tij nga Shejbe, Hasan ibën 'Urfeh nga Enesi, Ibën Xheriri nga Ka'b ibën Uxhreti dhe Ubej ibën Ka'bi, kurse Imam Ahmedi nga Ebu Musa. Edhe sahabët tjerë e cekin këtë komentim. Ibën Xheriri e ka shënuar nga Ebu Bekër es-Sidiku, Hudhejfeja dhe Ebu Musa, kurse e transmeton edhe Ibnu'l-Mubareku nga Ebu Musa. Po ashtu transmetohet nga Ibën Mes'udi, por edhe një grup i madh i tabi'inëve¹⁰² e kanë përkrahur këtë komentim.

4. Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿ كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُورُونَ ﴾

"Atë ditë do të jenë të penguar prej (ta shohin) Zotit të tyre".¹⁰³

Njëra nga dënimet më të mëdha për mosbesimtarët është ai se Allahu atyre nuk do t'ua mundësoj të shikojnë në fytyrën e Tij, dhe sikur edhe besimtarët të mos e shihnin dhe dëgjonin të folurit e Tij, edhe ata do të "pengohehin" sikur mosbesimtarët. Imam Shafiu dhe imamët tjerë e marrin këtë për argument për shikimin e fytyrës së Allahut, subhanehu ve teala.

Er-Rebi'u thotë: "O Ebu Abdullah, a je edhe ti i këtij qëndrimi?". "Po" - ka thënë ai "dhe me këtë ia dëshmoj besimin Allahut!".

5. Fjalët e Allahut të Lartësuar:

¹⁰¹ Junus: 26.

¹⁰² Tabi'inët janë gjeneratë e muslimanëve që kanë jetuar pas Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, nuk janë takuar me te, por me shokët e tij.

¹⁰³ El-Mutafifin: 15.

﴿لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ﴾

"Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshinë të parët".¹⁰⁴

Ky ajet mirret për argument në bazë të cilit mohohet mundësia e shikimit në fytyrën e Allahut, subhanehu ve teala, por njëkohësisht mund të shërben edhe si argument që e vërteton këtë mundësi. Kështu Ibën Abasi thotë se fjalët e Allahut, subhanehu ve teala, "La tudrikuhu'l-ebsar", kanë kuptim *Nuk mund Ta përfshijnë shikimet*. Katadeja i komenton në këtë mënyrë: "Allahu është më i madh se sa mund ta përfshijnë shikimet". Atiju thotë: "Do Ta shikojnë, por nuk do të mund ta përfshijnë me shikimin". Me fjalë tjera, është e pamundur ta përfshijë diç Atë, kurse Ai është që përfshin çdo gjë.

6. Fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿وَجُودَ يَوْمَئِذٍ نَاصِرَةٌ ﴿١٠٥﴾ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ﴾

"Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë".¹⁰⁵

Ibën Mirdevejuh në tefsirin e tij ka shënuar transmetimin nga Abdullah ibën Amër ibnu'l-Asi, radijallahu anhu, i cili thotë se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kështu i ka komentuar këto ajete: "Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera", nga shkëlqimi dhe bukuria, "Që Zotin e tyre e shikojnë", e shikojnë fytyrën e Allahut të Lartësuar. Ibën Abasi i komenton: "Do ta shikojnë fytyrën e Zotit të tyre të Lartësuar". Hasani tha: "E kanë shikuar Zotin e tyre, të Lartësuarin dhe Madhëruarin".

Hadithet që flasin për shikimin e Allahut, subhanehu ve teala, janë *mutevatir*.¹⁰⁶ Ata i transmetojnë Ebu Bekri,

Ebu Hurejre, Ebu Se'idi, Xherir ibën Abdullahu, Suhejbi, Ibën Mes'udi, Ali ibën Ebi Talibi, Ebu Musa, Adij ibën Hatimi, Enes ibën Maliku, Burejde, Ebu Rezini, Xhabiri, Ebu Umame, Zejd ibën Thabiti, Amari, Aishja, Ibën Umeri, Ubej ibën Ka'b ibën Uxhreja, Fudal ibën Ubejdi etj.

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu, se njerëzit kanë pyetur: "O i Dërguar i Allahut, a do ta shohim Zotin tonë në Ditën e Gjykimit?". Tha i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: "A ju vjen vështirë shikimi i hënës kur ajo është e plotë?". Thanë: "Jo, o i Dërguar i Allahut". Tha: "A ju vjen vështirë të shikoni diellin kur nuk e mbulojnë retë?". Thanë: "Jo". Tha: "Ju do ta shihni Atë ashtu".

Në të njëjtat përmbledhje të haditheve është shënuar nga Kajs ibën Ebu Hazimi: "Ishim duke ndejtur me Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, dhe ai shikoi hënën në natën e katërmëdhjetë të saj, pastaj tha: *Ju do ta shihni Zotin tuaj haptas sikurse e shihni këtë (hënë) dhe nuk do t'ju vijë vështirë shikimi i Tij*".

Në Sahihun e Muslimit është shënuar nga Suhejbi: "Ka thënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem: *Kur të hyjnë banorët e Xhenetit në Xhenet, u thotë Allahu i Lartësuar: 'A doni t'ju shtoj diç?'. Thonë: 'A nuk na i zbardhe fytyrat? A nuk na fute në Xhenet dhe na shpëtove nga zjarri?'. Tha Pejgamberi: 'Atëherë Allahu e heq perden (mes Tij dhe atyre), nuk ka për ta (banorët e Xhenetit) asgjë më të dashur se sa shikimi në Zotin e tyre të Lartësuar', mandej Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, e lexoi ajetin:*

¹⁰⁶ *Mutevatir* është hadithi të cilin e transmetojnë prej fillimi e deri në fund të senedit aq shumë njerëz sa që nuk ka kurrfarë dyshimi në autenticitetin e tij. Ky është hadithi me shkallën më të madhe të autenticitetit.

¹⁰⁴ El-En'am: 103.

¹⁰⁵ El-Kijame: 22, 23.

﴿لِّلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ وَلَا يَرْهَقُ وُجُوهَهُمْ قَتَرٌ وَلَا ذِلَّةٌ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ﴾

“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xheneti) edhe më tepër (e shohin Allahun)”¹⁰⁷

Po ashtu do të përmendim edhe atë se çfarë kanë thënë sahabët, tabi’inët dhe dijetarët e shquar islam pas tyre për shikimin e Allahut, subhanehu ve teala, në botën tjetër.

Ebu Bekri, radijallahu anhu, e ka lexuar ajetin: *“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xheneti) edhe më tepër (e shohin Allahun)!”*, kurse njerëzit e kanë pyetur: *“Çfarë kuptimi ka fjala ez-zijadeh (edhe më tepër), o halife i Pejgamberit të Allahut?”*. Ai është përgjigjur: *“Të shikuarit në fytyrën e Allahut të Lartësuar”*. Ngjashëm transmetohet edhe nga Hudhejfeja dhe Ebu Musa.

Nga Amar ibën Ubeji transmetohet se ka thënë: *“E kam dëgjuar Aliun duke thënë: Lumturi e plotë është të hyrët në Xhenet, kurse shikimi në fytyrën e Allahut të Madhëruar është në Xhenet”*.

Nga Abdullah ibën Hakimi transmetohet se ka thënë: *“E kam dëgjuar Abdullah ibën Mes’udin duke folur në xhami në Kufe: Pasha Allahun, çdo njeri në Ditën e Gjykimit do të mbetet vetë me Zotin e tij ashtu siç ndonjëri prej jush mbetet vetëm me hënën në natën e katërmbëdhjetë; atëherë do ta pyes: O Njeri çka të largoi nga rruga Ime e drejtë? Në çfarë mënyre u je përgjigjur pejgamberëve?”*.

Ibën Xheriri thotë: *“Për shikimin e Allahut, subhanehu ve teala, ka njëzet e tre transmetues që flasin për këtë”*.

Darekutni ka shënuar se Jahja ibën Me’ini se ka thënë: *“I kam shënuar shtatëdhjetë hadithe që flasin për shikimin e Allahut, subhanehu ve teala, dhe të gjithë janë autentike (sahih)”*.

¹⁰⁷ Junus: 26.

Bejhakiu thotë: *“Nuk është transmetuar nga asnjë sahabë që nuk është pajtuar me mundësinë e shikimit të Allahut, subhanehu ve teala. Sikur të kishte pasur mospajtje mes sahabëve për këtë çështje, ky mospajtje do të kishte arritur të ne, siç na është transmetuar, p.sh., divergjencia mes tyre se a do të shihet Allahu, subhanehu ve teala, në mënyrën siç shohim ne në këtë botë apo ndryshe”*.

Omer ibën Abdulazizi u ka shkruar disa nënpunësve të tij: *“Me devotshmëri ruhen robërit e Allahut nga zemërimi i Tij, për shkak të saj do të shoqërohen me pejgamberët e Allahut, për shkak të saj do të gëzohen fytyrat e tyre dhe do të shikojnë në Krijuesin e tyre”*.

Hasani thotë: *“Sikur disa njerëz të dinin se nuk do ta shohin Allahun e Lartësuar në botën tjetër, vyshken nga pikëllimi në këtë botë”*.

A’meshi thotë: *“Më të nderuarit do të jenë ata banorë të Xhenetit që do të kenë mundësi të shikojnë Allahun e Lartmadhëruar”*.



KAPITULLI I NJËZET E PESTË

MBI PËRJETËSINË DHE PËRHERSHMËRINË E
XHENETIT

Dihet me siguri se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka folur për përjetësinë e Xhenetit.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَمَّا الَّذِينَ سُعِدُوا فِي الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ إِلَّا مَا شَاءَ رَبُّكَ عَطَاءٌ غَيْرٌ مَجْدُودٌ﴾

"E për sa u përket atyre fatmirëve, ata janë në Xhenet përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt (Allahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur".¹⁰⁸

Nuk ekzistojnë kundërthënie në ajet mes fjalëve 'ata'en gajre mexhuz ((Allahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur) dhe fjalës *ila ma sha'e Rabuke* (përveç atë çka do Zoti yt). Ma'meri ka shënuar nga Ed-Dahaku: "Kjo ka të bëjë me ata që do të dalin nga Xhehenemi dhe hyjnë në Xhenet. Ata do të qëndrojnë në Xhenet përgjithmonë, pos periudhës që e kanë kaluar në Xhehenem".

Dijetarët e gjeneratave të mëvonshme kanë marrë tri qëndrime të ndryshme për çështjen e përjetësisë së Xhenetit dhe Xhehenemit, respektivisht karakterin e tyre kalimtar. Bëhet fjalë për këto mendime:

1. Xheneti dhe Xhehenemi janë kalimtare (do të zhduken), nuk janë të përjetshme dhe janë të krijuara.
2. Xheneti dhe Xhehenemi janë të përjetshme.

¹⁰⁸ Hud: 108.

3. Xheneti është i përjetshëm, kurse Xhehenemi ka karakter kalimtar (do të zhduket).

Qëndrimin për kalueshmërinë e Xhenetit dhe Xhehenemit e mbron Xhehëm ibën Safvani, udhëheqës i sektës së arratisur *xehmije* i cili asnjëherë nuk ka pasur pasues nga radhët e sahabëve dhe tabi'inëve. Sunitët i kanë shpallur mosbesimtarë, sepse ata kanë gënjyer mbi Kur'anin. Allahu i Lartësuar thotë: *"Frutet e Xhenetit janë të përherëshme, dhe hija e tij"*, derisa ata thonë se nuk janë të përherëshme. Ai, po ashtu thotë: *"Kjo do të jetë mirësi e Jonë, e cila asnjëherë nuk do të ndërpritet"*, kurse ata thonë se do të ndërpritet.

Në ajetin e sures Hud i cili është cekur në fillim të kapitullit, nuk ka kundërthënie mes fjalëve të Allahut '*ata'en gajre mexhuz* ((Allahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur) dhe fjalëve të tij *ila ma sha'e Rabuke* (përveç atë çka do Zoti yt). Komenti më i mirë i këtij ajeti domethënë se përcaktimi i Zotit ka të bëjë me atë se kategoria e robërve fatmirë të Allahut nuk do të qëndrojnë në Xhenet në Ditën e dhënies së llogarisë dhe ka kuptim përjashtimi (d.m.th., do të jenë në Xhenet përgjithmonë, pos Ditës së dhënies së llogarisë para Zotit, vër. e përkth.)

Disa thonë: "Grupi tjetër i dijetarëve janë të mendimit se Allahu, subhanehu ve teala, me këtë ajet lajmëron se fatmirët do të jenë në Xhenet përgjithmonë, por kjo është në kornizën e dëshirës dhe vullnetit të Allahut (d.m.th., nëse don Allahu mund t'i nxjerr prej Xhenetit, vër. e përkth.). Kështu për shembull Allahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë:

﴿وَلَكِن شِعْنَا لَنُدْهَبَنَّ بِالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ ثُمَّ لَا تَجِدُ لَكَ بِهِ عَلَيْنَا وَكِيلًا﴾

"Po të kishim dëshiruar, Ne do ta shlyenim nga gjoksi yt atë që ta shpallëm ty..."¹⁰⁹

¹⁰⁹ El-Isra: 86.

﴿...فَإِنْ يَشَأِ اللَّهُ يُخَيِّمَ عَلَىٰ قَلْبِكَ...﴾

*"Po të deshte Allahu, Ai mund ta kishte vulosur zemrën tënde..."*¹¹⁰

E përbashkët e gjithë këtyre qëndrimeve është se Allahu, subhanehu ve teala, tregon se fatmirët do të qëndrojnë përgjithmonë në Xhenet, përveç kur Ai këtë nuk do ta dëshirojë, dhe kjo nënkupton kohën e qëndrimit të tyre në këtë botë, në Berzah, qëndrimin në Ditën e Gjykimit, kalimin mbi Urën e Siratit, qëndrimi i disave prej tyre në Xhehenem një kohë të caktuar dhe çdo kohë tjetër që përcakton Allahu, subhanehu ve teala. Prandaj, ajetin e cekur (në fillim të kapitullit) mund ta rendisim në radhën e ajeteve *muteshabih*.¹¹¹

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ebu Se'idi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: *"Vdekja do të vjen në formë të dashit të zi dhe do të ndalet mes Xhenetit dhe Xhehenemit. Mandej do të thuhet: 'O banorë të Xhenetit, e ata do të paraqiten të shqetësuar', dhe do të thuhet: 'O banorë të Xhehenemit, e ata do të paraqiten të gëzuar'. Pastaj do të pyeten: 'A e dini se ç'është kjo?'. Ata do të përgjigjen: 'Po. Kjo është vdekja'. Mandej ajo (vdekja) do të theret mes Xhenetit dhe Xhehenemit dhe do të thuhet: 'O banorë të Xhenetit, aty do të qëndroni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni! O banorë të Xhehenemit, aty do të qëndroni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni!'".*

¹¹⁰ Esh-Shura: 24.

¹¹¹ Ajetet *Muteshabih* janë ajetet e Kur'anit që nuk janë shumë të qarta. Për këto ajete Allahu tregon në ajetin e 7-të të sures Ali Imran: *"Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih)"*. Shumica e komentatorëve të Kur'anit konsiderojnë se kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu, subhanehu ve teala, kurse ne si besimtarë, jemi të detyruar që t'i besojmë ato.

Kur është në pyetje përhershmëria e Xhehenemit, Shejhul Islami (Ibën Tejmije) thotë se për këtë çështje ka dy qëndrime që transmetohen nga gjeneratat e mëparshme. Unë konsideroj se janë shtatë:

1. Se ata që hyjnë në Xhehenem, nuk do të dalin prej tij asnjëherë, ky është qëndrim i harixhinjëve dhe mu'tezilive.

2. Se banorët e Xhehenemit do të dënohen aty një kohë të caktuar, mandej do të përjetojnë transformim, do ta përvetësojnë natyrën e zjarrit e cila do të jetë e këndshme për ta, sepse ajo i përgjigjet natyrës së tyre. Ky është qëndrim i Ibën Arabiut.

3. Se banorët e Xhehenemit do të dënohen aty një kohë të caktuar, mandej do të dalin prej tij, ku do t'i zëvendësojnë të tjerë. Ky qëndrim konsiderohet jo i saktë në Kur'an:

﴿وَقَالُوا لَنْ نَمَسَّ النَّارَ إِلَّا أَيَّامًا مَعْدُودَةً قُلْ أَتَّخَذْتُمْ عِنْدَ اللَّهِ عَهْدًا فَلَنْ يُخْلِفَ اللَّهُ عَهْدَهُ أَمْ تَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ﴾

*"Ata edhe thanë: Neve nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara! Thuaj: A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim, e Allahu nuk e thyen premtimin e vet, ose jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini?"*¹¹² Ky është qëndrim i çifutëve.

4. Banorët e Xhehenemit do të dalin prej tij, do të mbetet Xhehenemi, por askush nuk do të dënohet në te. Ky qëndrim kundërshtohet me Kur'anin dhe Sunetin.

5. Xhehenemi është i kalueshëm (do të zhduket) nga vetvetiu, sepse është i krijuar dhe krijimi i tij nuk lejon mundësinë të jetë ai i përhershëm. Ky është qëndrim i Xhehmiut dhe pasuesve të tij.

¹¹² El-Bekare: 80.

6. Do të përfundojë jeta dhe lëvizjet e banorëve të Xhehenemit, kështu që nuk do të ndiejnë dhimbje, ky është qëndrim i Ebu'l-Huzejle el-Allafit.

7. Allahu, Krijuesi i Xhehenemit, do ta bëjë kalimtar dhe do t'i caktojë kohëzgjatje.

Shejhu'l-islami thotë: "Ky qëndrim transmetohet nga Omeri, Ibën Mes'udi, Ebu Hurejre, Ebu Se'idi dhe të tjerë". Abd ibën Humejdi, njëri nga njohësit më të mirë të hadithit, transmeton se Omeri, radijallahu anhu, ka thënë: "Edhe sikur xhehenemlinjtë të qëndronin në Xhehenem sa ka rërë në brigjet e rërës, prapë do të vijë dita kur do të dalin prej tij".

Transmetohet nga Omeri, radijallahu anhu, se duke e komentuar qëndrimin e tij, ka cekur ajetin e Allahut të Lartësuar:

"Aty do të mbesin për tërë kohën (pa mbarim)".¹¹³

Për vërtetimin e senedit të tij, mjafton autoriteti i tij.

Ata që thonë se Xhehenemi është i përhershëm, qëndrimin e tyre e argumentojnë me konsensusin e dijetarëve për përhershmërinë e tij (mirëpo, konsensusi për këtë çështje nuk është arritur) dhe me atë që Kur'ani udhëzon në përhershmërinë e dënimit në Xhehenem. Është e vërtetë që Kur'ani udhëzon në këtë, por është kontestuese se a është vetë Xhehenemi kalimtar apo i përhershëm. Kur'ani udhëzon në atë se banorët e Xhehenemit do të dënohen përgjithmonë në te derisa ai të ekzistojë.

Dallimi në afatin e kohëzgjatjes së Xhenetit dhe Xhehenemit me Sherijat dhe racionalisht, shihet në disa aspekte:

1. Allahu na lajmëron për vazhdueshmërinë e kënaqësive të banorëve të Xhenetit dhe përjetësinë e vetë Xhenetit, kurse kur flet për Xhehenemin, atëherë flet vetëm për atë se banorët e tij do të mbeten aty dhe se nuk do të dalin prej tij. Dallimi mes këtyre dy lajmeve është evident.

¹¹³ En-Nebe: 23.

2. Allahu, subhanehu ve teala, duke folur për Xhehenemin, në tri vende në Kur'an tregon se ai nuk është i përhershëm:

﴿... قَالَ الشَّارُّ مَوَاتِكُمْ خَالِدِينَ فِيهَا إِلَّا مَا شَاءَ...﴾

"Ai do t'u thotë: Zjarri do të jetë vendbanimi juaj për të banuar aty ngaherë (dhe nuk është ndryshe), veçse si të dojë Allahu".¹¹⁴

﴿خَالِدِينَ فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ إِلَّا مَا شَاءَ رَبُّكَ إِنَّ رَبَّكَ فَعَّالٌ لِّمَا يُرِيدُ﴾

"Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt...".¹¹⁵

﴿لَا يَلْبِثِينَ فِيهَا أَحْقَابًا﴾

"Aty do të mbesin për tërë kohën (pa mbarim)".¹¹⁶

Duke treguar se çfarë do të bën me banorët e Xhehenemit, Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

﴿إِنَّ رَبَّكَ فَعَّالٌ لِّمَا يُرِيدُ﴾

"...vërtet Zoti yt punon çka dëshiron".¹¹⁷ Kurse kur flet për shpërblimet e banorëve të Xhenetit thotë se është kjo "dhuratë pa fund", që na jep me dije se Allahu, subhanehu ve teala, don të bën diç për të cilën nuk na ka lajmëruar duke folur posaçërisht për Xhehenemin. Bëhet fjalë për atë se dënimi në te është i përkohshëm dhe nuk është kushtëzuar me shpërblimin e Xhenetit.

¹¹⁴ El-En'am: 128

¹¹⁵ Hud: 107.

¹¹⁶ En-Nebe: 23.

¹¹⁷ Hud: 107.

Xheneti është pasojë e mëshirës së Allahut, subhanehu ve teala, kurse Xhehenemi - i zemërimit të Tij. Por, mëshira e Tij e ka mbizotëruar zemërimin e Tij, siç është shënuar në *Sahih*, në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem: "Kur Allahu i Lartmadhëruar e krijoi këtë botë (krijesat), me Dorën e Tij shkroi (caktoi) për Vetën: 'Vërtet, mëshira Imë e ka mbizotëruar hidhërimin Tim.'" Pasi që kënaqësia e Tij e ka mbizotëruar zemërimin, është e pamundur të barazohet ajo çka për pasojën ka mëshirë dhe ajo çka për pasojën ka zemërimin. Ajo që është në mëshirën, është ajo që ka qenë e preferuar si e tillë, derisa ajo që është në zemërim, është e krijuar të jetë e anashkaluar, si mjet, prandaj është tejkualuar ngase si e tillë nuk ka qenë qëllim.

Mirësitë e Xhenetit janë nga Allahu, subhanehu ve teala, kurse dënimi i Xhehenemit është pasojë e veprave të këqija të njeriut. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

﴿ تَبَيَّنَ عِبَادِي أَنِّي أَنَا الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ﴿١١٨﴾ وَأَنَّ عَذَابِي هُوَ الْعَذَابُ الْأَلِيمُ ﴿١١٩﴾

"Njoftoi robërit e Mi se vërtet Unë jam Ai që fal shumë dhe mëshirues i madh. Po (njoftoi) se edhe dënimi Im është ai dënim i dhembshëm".¹¹⁸

﴿ اعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ وَأَنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١١٩﴾

"Dijeni se Allahu është ndëshkues i rreptë, dhe dijeni se Allahu është Dhurues, është Mëshirues".¹¹⁹

Ajo që është pasojë e veprimit të emrave dhe cilësive të Allahut ka aq afat sa edhe ato emra dhe cilësi. Mirëpo, ato nuk reflektojnë faktin se Ai është i Cili dënon vazhdimisht.

¹¹⁸ El-Hixhër: 49, 50.

¹¹⁹ El-Maide: 98.

KUSH DO TË HYJË I FUNDIT NË XHENET?

Në përmbledhjet e haditheve të Buhariut dhe Muslimit është shënuar nga Ibën Mes'udi, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Unë e di njeriun e fundit që do të del nga zjarri dhe të fundit që do të hyn në Xhenet: është një njeri që del nga zjarri duke u zvarritur, Allahu i thotë atij: 'Shko dhe hyn në Xhenet!'. Kur ai vjen aty, i duket sikurse është mbushur plot, kthehet e thotë: 'O Zot, e gjeta të plotë'. Allahu i Lartësuar i thotë: 'Shko dhe hyn në Xhenet; ti aty ke sa dynjaja dhe sa dhjetë herë ajo!'. I thotë ai: 'A përqeshesh me mua dhe Ti je Mbreti?!'". Tha: (Abdullah ibën Mes'udi): "Qeshi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, derisa iu dukën dhëmballët e tij. Flitej se ai është njeriu me pozitën më të ulët në Xhenet".

Në *Sahihun* e Muslimit është shënuar nga Ebu Dherri, radijallahu anhu, se Pejgamberi i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Unë e di njeriun e fundit që do të del nga zjarri dhe të fundit që do të hyjë në Xhenet. Një njeri do të sjellet në Ditën e Gjykimit, dhe do të thuhet: Ia tregoni mëkatet e tij të vogla, kurse largoni prej tij mëkatet e mëdha. Do t'i ekspozohen mëkatet e tij të vogla, dhe Allahu do t'i thotë: Këtë ditë e ke bërë këtë dhe këtë, ke vepruar kështu dhe kështu. Njeriu do të vërteton: Po, nuk do të mund të mohoj, por do të frikohet se mos po i ekspozohen mëkatet e mëdha. Do t'i thuhet: Punët e tua të këqija të janë zëvendësuar me të mira. Njeriu do të thotë: O Zot, kam bërë punë të cilat nuk po i shoh këtu". Ebu Dherri shton: "Qeshi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, derisa iu dukën dhëmballët e tij".

KAPITULLI I NJËZET E SHTATË

MBI ATA QË E MERITOJNË LAJMIN E GËZUAR

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَيُبَشِّرُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ... ﴾

"E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në xhenete në të cilët rrjedhin lumenj".¹²⁰

Ai po ashtu thotë:

﴿ إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ أَلَّا تَخَافُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَبْشِرُوا بِالْجَنَّةِ الَّتِي كُنتُمْ تُوعَدُونَ ﴾

"E, s'ka dyshim se ata që thanë: Allahu është Zoti ynë, dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijonë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhde Xhenetin që u premtohen".¹²¹

Në Kur'an ka shumë ajete që besimtarëve u sjellin lajme të gëzueshme për Xhenetin, kurse ai arrihet me tri gjëra: me iman, devotshmëri dhe punë të sinqertë në emër të Allahut, subhanehu ve teala, në përputhje me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem. Ky lajm i gëzuar është për ata që i plotësojnë këto tri parime, por jo edhe për të tjerët. Mbi këto pra, mbështeten lajmet e gëzuara të Kur'anit dhe Sunetit, për to janë të përbashkëta dy veçori: sinqeriteti në nënshtrueshmërinë ndaj Allahut dhe bamirësia ndaj krijesave të Tij. Pastaj reduktohen në një

¹²⁰ El-Bekare: 25.

¹²¹ Fusilet: 30.

karakteristikë që njeriu të dojë ate që e don Allahu i Lartësuar.

Ekzistojnë shtatëdhjetë e disa pjesë që i përbëjnë pjesët përbërëse të veçorisë së epërme. Më e larta prej atyre pjesëve është të thënurit e fjalës *La ilahe ilallah* (Nuk ka zot pos Allahut), kurse më e ulta, të larguarit e pengesës prej rruge. Mes këtyre dy pjesëve janë pjesët tjera përbërëse, ku bën pjesë edhe: të besuarit e gjithë asaj për të cilën na ka lajmëruar Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe të bërrit *itat* Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, në gjithë ate që ka urdhëruar, duke e miratuar këtë me kënaqësi.

Ai i cili pohon se imani nënkupton fjalë pa punë apo imani nënkupton fjalë, kurse veprat bien në besim (ligji i besimit), ai është *murxhij*.¹²² Ai i cili pohon se imani mund të rritet, por jo edhe të zvogëlohet, po ashtu është *murxhij*. Ai që thotë se imani i tij është sikur imani i melekëve, po ashtu është *murxhij*. Caktimi, i të mirës ose të keqes, të ëmblës ose të idhtës, të dashurës ose të mënishmës, është përcaktuar nga Allahu. Allahu e ka caktuar dhe përcaktuar për robërit e Tij, dhe askush prej tyre nuk është përjashtuar nga vullneti i Allahut, e as që do ta anashkalojë Ai. Përkundrazi, secilin prej tyre do ta godet ajo që e ka caktuar Allahu për te.

Imoraliteti, vjedhjet, konsumimi i alkoolit, mbytja, marrja e pasurisë së ndaluar, politeizmi dhe gjitha mëkatet tjera ekzistojnë në bazë të përcaktimit të Allahut, por kjo nuk është pretekst për asnjë kijesë të Allahut (që mund t'i veprojë, vër. e përkth.), por argument i qartë i Allahut për ta. Allahu nuk do të pyetet për ate që Ai bën, por do të pyeten krijesat e Tij.¹²³

¹²² *Murxhitë*, si njëra prej sekteve më të vjetra të muslimanëve, kanë mësuar se veprat nuk janë pjesë përbërëse e besimit, dhe si pasojë e kësaj mendojnë se imani nuk shtohet as nuk pakësohet.

¹²³ Do të pyeten për punët e tyre në përputhshmëri me dispozitat e Sherijatit. Allahu i Lartësuar është Krijues i punëve të mira dhe të

Ne nuk themi se secili prej atyre që kthehen kah Kiblja do të jenë në Xhehenem për shkak të mëkateve të tyre, pos nëse kështu është përmendur në hadith, as që themi për ndokend se do të jetë banor i Xhenetit për shkak të punëve të mira që i ka bërë, pos nëse kështu thuhet në hadith. Kënaqemi me atë që ata të kthehen kah Kiblja, dhe askend prej tyre nuk e shpallim mosbesimtar për shkak të mëkateve, as që e përjashtojmë nga Islami, pos nëse kështu është përmendur në hadith.

Dexhalli është i vërtetë, vuajtjet e varrit janë të vërteta, burimi (*havdi*) i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, është i vërtetë, Ura e Siratit është e vërtetë, pllaka e ruajtur mirë (*Levhi Mahfudh*), është e vërtetë dhe ndërmjetësimi (*shefa'ati*) është i vërtetë. Ai që i fyen sahabët e Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, apo njerin prej tyre, ose i përshkruan ndonjë të metë është *rafidij*¹²⁴ i prishur. Dashuria ndaj sahabëve është rruga e besimtarëve, duaja për ta është punë e mirë, marrja e tyre për shembull (model) është *vesilet*¹²⁵, kurse imitimi i punëve të tyre është virtyt.

Katër halifet e drejtë janë njerëzit më të mirë pas Pejgamberit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, dhe nuk lejohet që ndokush të shpif diç për ta. Nëse ndokush e bën këtë, sunduesi duhet ta sanksionon, nuk guxon t'i anashkalojë këto veprime.

këqija, kurse njerëzit janë miratues të këtyre punëve. Ajo që Allahu e ka krijuar të keqen, nuk do të thotë se Ai edhe e ka urdhëruar këtë, përkundrazi e ka krijuar për tjetër qëllim. Urdhëri nuk është i njëjtë me krijimin: "*Padyshim që i Tij është Krijimi dhe Komandimi*" (El-A'raf, 54). Është bërë dallim mes krijimit dhe komandimit me lidhëzen *dhe*.

¹²⁴ *Rafiditë* janë sektë ekstreme e shi'itëve.

¹²⁵ Në Islam nuk ka ndërmjetësim mes Zotit dhe krijesës. Çdo njeri në mënyrë direkte mund t'i drejtohet Zotit të tij. Mirëpo, mund të presim mëshirën dhe shpërblimin e Allahut nëse i përcjellim (i marrin si ynë) robërit e Tij të denjë, mes të cilëve janë edhe katër halifet e drejtë. Në këtë kuptim duhet kuptuar termin *vesilet*.

Imam Ibn Kajjimi, dijetarë i dalluar, i njohur me thellimin e tij në horizontet e gjëra të shkencave islame, me shkoqitjen dhe ekspozimin e argumenteve, me njohjen e gjithmbarshme të Sunnetit dhe Kur'anit dhe orientimin në ate që njerëzit kanë nevojë për të ecurr rrugës së drejtë siç janë urdhëruar, si dhe të ruhen nga e ndaluara siç janë paralajmëruar. Njëra nga librat e tij më të rëndësishme është *Hadî'l-er'vali ila biladi'l-efrali*, "Udhëzuesi i shpirtave në rajonet (fushat) e lumturisë" ku ai, në lidhje me xhenetin dhe qështjet lidhur me te flet me mjaft nxitje, dhe në mënyrë plotësisht origjinale, derisa për xhehenmin dhe ate që është e lidhur për te nuk thotë asgjë nga vetja e tij, por e cekë vetëm ate që kanë thënë të tjerët për këtë.

